


Qeverisja

e internetit

në Shqipëri dhe roli i
saj në lirinë e medias





Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Qeverisja e internetit në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias

Korrik, 2020

Publikuar nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri
<http://birn.eu.com/>

Autorë: Ermal Nazifi
Michael J. Oghia

Redaktorë: Besar Likmeta
Kristina Voko

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Tiranë, 2020



Ky raport është prodhuar dhe printuar me ndihmën financiare të Bashkimit European. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij raporti është e BIRN Albania dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit European.

PËRMBAJTJA

I.

HYRJE

11

II.

LIRIA E SHPREHJES
DHE LIRIA E
MEDIAS

16

III.

AKSESI NË INTERNET
NË SHQIPËRI

25

IV.

REGJISTRIMI I
ADRESAVE DHE
HOSTIMI

28

V.

RREGULLIMI
FINANCIAR DHE
FISKAL PËR MEDIAN
ONLINE

37

VI.

PRONËSIA DHE
KONKURRENCA

42

VII.

KUFIZIMET E LIRISË
SË SHPREHJES NË
INTERNET

49

VIII.

HEQJA E
PËRMBAJTJES SË
PALIGJSHME

72

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

3G	Teknologjia e komunikimit të lëvizshëm e gjeneratës së tretë
4G	Teknologjia e komunikimit të lëvizshëm e gjeneratës së katërt
ACCC	Akronim në anglisht për: Komisioni Australian për Konkurrencën dhe Mbrojtjen e Konsumatorit
ACESK	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
ADSL	Akronim në anglisht për: Linjë Asimetrike për Abonim Digjital
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AMA	Autoriteti i Medias Audiovizive
AMFL	Autoriteti Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit
APC	Akronim në anglisht për: Shoqata për Komunikime Progresive
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Akronim në anglisht për: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative
ccTLD	Akronim në anglisht për: kodi i vendit për domain-e të nivelit të lartë
CDT	Akronim në anglisht për: Qendra për Demokraci & Teknologji
CII	Akronim në anglisht për: Infrastruktura Kritike e Informacionit

CSCE	Akronim në anglisht për: Komisioni për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
CSIRT	Akronim në anglisht për: Skuadra e Reagimit për Incidentet në Sigurinë Kompjuterike
DCPR	Akronim në anglisht për: Koalicionin Dinamik për Platformën e Përgjegjshmërisë
DNS	Akronim në anglisht për: Sistemi i Emrave Domain
ECPMF	Akronim në anglisht për: Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias
EDRI	Akronim në anglisht për: Iniciativa Evropiane për të Drejtat Digjitale
GAC	Akronim në anglisht për: Komiteti Këshillues Qeveritar
GDPR	Akronim në anglisht për: Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave
GFMD	Akronim në anglisht për: Forumi Botëror për Zhvillimin e Medias
GNI	Akronim në anglisht për: Iniciativa për Rrjetin Global
GPD	Akronim në anglisht për: Partnerët Digjitalë Globalë

gTLD	Akronim në anglisht për: Domain gjenerik i nivelit të parë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ICANN	Akronim në anglisht për: Korporata e Internetit për Numrat dhe Emrat e Caktuar
ICT	Akronim në anglisht për: Teknologjia e Informimit dhe Komunikimeve
IGF	Akronim në anglisht për: Forumi i Qeverisjes së Internetit
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISP	Akronim në anglisht për: Ofrues i Shërbimit të Internetit
IT	Akronim në anglisht për: Teknologjia e Informacionit
ISHM	Instituti Shqiptar i Medias
ITU	Akronim në anglisht për: Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve
JTI	Akronim në anglisht për: Iniciativa për Trustin e Gazetarisë
JUFREX	Akronim në anglisht për: Projektit për Përforcimin e Ekspertizës Juridike në Lirinë e Shprehjes dhe të Medias në Evropën Juglindore
KE	Komisioni Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

LGBTQ	Lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, dhe <i>queer</i>
NUIS	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
OHCHR	Akronim në anglisht për: Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në OKB
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuar
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OTT	Akronim në anglisht për: Ofruesit e medias <i>Over-the-top</i>
RSF	Akronim në anglisht për: Reporterë Pa Kufi
SDG	Akronim në anglisht për: Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
SHPK	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
TLDs	Akronim në anglisht për: domain-e të nivelit të parë
ToS	Akronim në anglisht për: Kushtet e përdorimit
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
UNESCO	Akronim në anglisht për: Organizata e OKB-së për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
VLT	Terminal lotarie video
WEF	Akronim në anglisht për: Forumi Ekonomik Botëror



PARATHËNIE

Raporti “Qeverisja e internetit në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias” u realizua nga BIRN Albania si pjesë e projektit “Rritja e Ndërgjegjësimit Kritik mbi Qeverisjen e Internetit në Shqipëri”, financuar nga Komisioni Evropian, i përfaqësuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe i zbatuar në partneritet me Institutin Shqiptar të Medias (ISHM) dhe Federatën Ndërkombëtare të Gazetarëve (IFJ). Përmes këtij studimi mbi qeverisjen e internetit, BIRN Albania synon të ofrojë një peizazh realist dhe të lehtë për t’u kuptuar të panoramës aktuale ligjore për ofruesit e përmbajtjes dhe për median *online*, si dhe të eksplorojë çështjet dhe proceset kryesore që mbivendosen mes zhvillimit të medias dhe qeverisjes së internetit, në mënyrë që të informojë aktorët e fushës dhe debatin publik. Raporti eksploron një numër temash ku qeverisja në internet dhe rregullimet e këtij sektori ndërthuren me median *online*, kushtet e tregut, rregulloret financiare, çështjet e pronësisë dhe konkurrencës, aksesit në informacion dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe çështje të të drejtave të autorit dhe të sigurisë kibernetike – ndërsa ofron shembuj nga bota reale kur abuzimi me përkufizimet e paqarta nëpër këto rregullore sjell kufizime në lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në vend.



I. HYRJJE



Sipas organizatave vendëse dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave, mjedisi i medias në Shqipëri është përkeqësuar gjatë viteve të fundit, nën një qeveri që gjithnjë e më shumë ka kufizuar aksesin e gazetarëve dhe është përpjekur të kufizojë legjislacion që nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare¹. Kjo ka ngritur shqetësimin se Shqipëria nuk po respekton detyrimet që ka si anëtar i Këshillit të Evropës dhe OSBE-së, dhe si një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian².

Politikanët përdorin tashmë rrjetet e medias sociale për të komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me votuesit, në mënyrë që të kontrollojnë përmbajtjen, ndërkohë që kufizojnë aksesin për reporterët duke anashkaluar në këtë proces median kritike, duke zvogëluar rolin e gazetarëve si rojtarë të interesit publik dhe si kërkues llogarie ndaj atyre në pushtet, si dhe duke “gërryer” aftësinë e gazetarëve për të dhënë një këndvështrim të paanshëm mbi veprimet e personave në pushtet.

Një numër në rritje padish për shpifje, shoqëruar me fushata të orkestruara baltosjeje dhe sulmesh verbale, të cilat në disa raste vijnë nga rangjet më të larta të pushtetit, si *online* ashtu edhe *offline*, kanë krijuar një mjedis në të cilin gazetarët vetë-censurohen dhe shmangin raportimin nga temat politikisht sensitive³.

Indeksi i Reporterëve Pa Kufi për vitin 2020⁴ mbi lirinë e medias e renditi Shqipërinë në vend të 84^{rt} nga 180 vende, një rënie me dy pozicione në krahasim me vitin e mëparshëm. Raporti

¹ Joint Statement, 2019, “Mission preliminary findings: Press freedom is deteriorating in Albania”, <https://europeanjournalists.org/blog/2019/06/21/albania-preliminary-findings-of-joint-freedom-of-expression-mission/>

² Balkan Insight, 2019, “Albania’s EU Commitment Questioned over Media ‘Censorship’ Laws”, <https://balkaninsight.com/2019/12/30/albanias-eu-commitment-questioned-over-media-censorship-laws-2/>

³ Reporters Without Borders dhe BIRN Albania, 2018, “Monitori i Pronësisë së Medias - Media nën presion”, <https://albania.mom-rsf.org/sq/gjetjet/media-nen-presion/>

⁴ Reporters Without Borders, 2020 World Press Freedom Index, <https://rsf.org/en/albania>

nënvijëzoi se gjatë vitit 2019, qeveria ka përshkallëzuar përpjekjet e saj për të kontrolluar median nën maskën e luftës kundër lajmeve të pavërteta (*Fake News*) dhe dizinformimit, në veçanti pas një tërmeti vdekjeprurës të shënuar më 26 nëntor 2019. Sulmet e qeverisë kundër medias në Shqipëri janë përqendruar në veçanti kundër organeve mediatike *online*, të cilat janë më të larmishme dhe shpesh janë kritike ndaj vendimeve të qeverisë.

Media online në Shqipëri

Një vërtetim i kryer në vitin 2019 nga Instituti i Statistikave (INSTAT),⁵ mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit nga familjet dhe individët në Shqipëri, gjeti se 82.2 për qind e familjeve shqiptare tashmë kanë akses në internet. Përhapja e shpejtë e internetit dhe përdorimi në rritje i medias sociale në vend ka prekur në mënyrë domethënëse sjelljen e mediave ekzistuese tradicionale si dhe mediave të reja të lindura në botën digjitale⁶. Sipas Unionit të Gazetarëve, më shumë se 800 publikime të medias *online* operojnë në Shqipëri,⁷ të cilat variojnë nga faqe interneti të mediave tradicionale te platformat e reja multimediale dhe blogjet. Gjithsesi, nuk ka një regjistër të plotë të publikimeve të tilla dhe nuk ka informacion mbi popullaritetin apo mbi fuqinë e strukturave dhe praktikave të tyre editoriale.

Të dhënat nga Barometri i Ballkanit më 2018⁸ sugjerojnë se edhe pse shqiptarët e përdorin internetin kryesisht për të komunikuar me familjen, miqtë dhe kolegët, dy kategoritë vijuese për nga madhësia të përdoruesve janë ata që e përdorin internetin për lajme dhe për dëfrim, me një tendencë në rritje për lajmet, kryesisht përmes medias *online* por edhe përmes medias sociale. Përhapja e telefonave “të zgjuar” dhe paketat më ekonomike të komunikimit të ofruara

⁵ Instituti i Statistikave (INSTAT), 2019, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët 2018-2019, <http://www.instat.gov.al/media/6435/anketa-mbi-p%C3%ABrdorimin-e-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt-2018-2019.pdf>

⁶ Ilda Londo, 2017, Online Media in Albania – Not Yet a Game Changer, http://seemediapartnership.cji.ro/wp-content/uploads/2018/01/Rep_Albania_2017.pdf

⁷ Vertetmates.mk, 2020, “Çipa: Media pësoi goditje të rëndë nga pandemia, mbi 40 gazetarë humbën vendin e punës ndërsa rreth 30% e gazetarëve pësuan ulje të pagave”, <https://vertetmates.mk/cipa-media-pesoi-goditje-te-rende-nga-pandemia-mbi-40-gazetare-humben-vendin-e-punes-nderkaq-rreth-30-e-gazetareve-pesuan-ulje-te-pagave/>

⁸ Regional Cooperation Council, 2018, “Balkan Barometer 2018”, <https://www.rcc.int/pubs/66/balkan-barometer-2018-public-opinion-survey>

nga kompanitë e telekomunikacionit⁹ kanë pasur një ndikim veçanërisht të fuqishëm në rritjen e lexueshmërisë së medias *online* përgjatë viteve të fundit.

Një vërtetim i kryer më 2017 nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, IDRA, tregoi se media *online* është një nga tre burimet kryesore të informacionit për 44 për qind të popullsisë – duke u renditur e dyta pas televizioneve dhe duke lënë pas shtypin dhe radiot.¹⁰ Studime të ngjashme tregojnë dallime të konsiderueshme në zgjedhjen e burimeve të informacionit mes grupmoshave të ndryshme të popullsisë. Të rinjtë kanë tendencën të përdorin kryesisht median *online* si burim informacioni – 67 për qind e tyre – në krahasim me 30 për qind që përdorin televizionin. Vetëm 1.6 për qind mbështeten te informacioni nga shtypi dhe vetëm 1.4 për qind nga radio.¹¹

Shfaqja e medias *online* ka ndryshuar në mënyrë dramatike panoramën mediatike në Shqipëri. Rritja e numrit dhe masës së ndikimit të medias *online* i ka dhënë gazetarëve më shumë hapësirë dhe liri për të shprehur këndvështrimet e tyre dhe për të raportuar mbi çështje të ndryshme të cilat jo gjithmonë janë të mirëpritura në median tradicionale.¹² Gjithsesi, shpërthimi i mediave të reja *online* ka ngritur gjithashtu edhe shqetësimin mbi profesionalizmin, tabloidizimin, problemet etike, abuzimin me të dhënat personale dhe probleme me të drejtat e autorit. Kjo ka shkaktuar debat mes aktorëve se si është më mirë të rregullohet ky mjedis i ri pa kufizuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në internet.

Media audiovizuale në Shqipëri rregullohet me ligj ndërsa zbatimi i ligjit mbikëqyret nga Autoriteti i Medias Audiovizive. Ligji “Për shtypin në Republikën e Shqipërisë” ka një nen të vetëm që thotë se shtypi është i lirë. Megjithatë nuk ka ligj të posaçëm për median *online* në Shqipëri, parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit shtrihen me të drejtat dhe kufizimet edhe te mediat *online*, ndërsa mjedisi rregullator mbi qeverisjen e internetit, si vendës ashtu edhe i huaj,

⁹ Reporters Without Borders dhe BIRN Albania, 2018, “Monitori i Pronësisë së Medias”, <https://albania.mom-rsf.org/sq/>

¹⁰ Institute for Development, Research and Alternatives, 2017, “Impunity- Perceptions and experience of Albanian Citizens”, https://www.idrainstitute.org/files/impunity_final_report_2017.pdf

¹¹ Briseida Mema, 2016, Dilemmas on information in the digital era – the Albanian case, qtd. in Albanian Media Institute, “Online media in Albania: legislation, self-regulation, development, and main tendencies.”

¹² Ilda Londo, 2017, Online Media in Albania – Not Yet a Game Changer, http://seemediapartnership.cji.ro/wp-content/uploads/2018/01/Rep_Albania_2017.pdf

ndikon mënyrën se si këto media operojnë dhe bëjnë biznes.

Ndërsa tregu i medias *online* zhvillohet dhe ushtron ndikim në rritje mbi politikat publike, qeveria ka bërë disa përpjekje për ta rregulluar atë, qoftë përmes ndryshimeve të ligjit “Për tregtinë elektronike”, qoftë përmes përpjekjes së fundit për të zgjeruar fushën e veprimtarisë së Autoritetit të Medias Audiovizive mbi mediat *online* nën maskën e luftës kundër *fake news* dhe dezinformimit. Në dhjetor 2019, parlamenti miratoi dy ligje mbi median si pjesë e të ashtuquajturës “paketa antishpifje” të cilat synonin të fuqizonin këtë organ administrativ me mundësinë për të marrë ankesa mbi mediat *online*, të urdhërojnë korrigjime dhe të imponojë gjoba me vlerë deri 8 mijë euro¹³.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në ligjin për median audiovizive dhe në ligjin “Për Komunikimet Elektronike” synuan të fuqizonin Këshillin e Ankesave të Autoriteti të Medias Audiovizive për të vlerësuar përmbajtjen e publikimeve të mediave *online* dhe për të vepruar si *quasi* (thuajse)-gjykatë.

Rregullimet e propozuara u përballën me rezistencë të fuqishme nga bashkësia e gazetarëve dhe organizatat e të drejtave në Shqipëri dhe nëpër botë¹⁴. Ato u kundërshtuan gjithashtu nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, të cilat i cilësuan ndryshimet si kërcënime për lirinë e shprehjes. Në një opinion të kërkuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Komisioni i Venecias paralajmëroi se nëse rregullimet e propozuara miratoheshin pa ndryshime, ato do të kishin një efekt frikësues mbi lirinë e medias¹⁵.

Synimi i raportit:

Në kontekstin e rritjes së kërcënimeve për rregullim të medias *online* në Shqipëri dhe mes përpjekjeve nga bashkësia mediatike për t’u vetë rregulluar është e rëndësishme për palët e

¹³ Balkan Insight, 2019, Albania Approves Controversial Media Laws Despite Bitter Protests, <https://balkaninsight.com/2019/12/18/albania-approves-controversial-media-laws-amidst-protests/>

¹⁴ Balkan Insight, 2019, Albania Govt Ignores Outcry Against Online Media Laws, <https://balkaninsight.com/2019/12/13/albania-govt-ignores-outcry-against-online-media-laws/>

¹⁵ Komisioni i Venecias, 2020, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF\(2020\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF(2020)007-e)

interesuara për të kuptuar mjedisin ligjor dhe kuadrin në të cilat këto platforma operojnë, diçka që njihet gjithashtu edhe si qeverisja e internetit. Qeverisja e internetit kuptohet si zhvillimi dhe aplikimi nga qeveritë, sektori privat dhe shoqëria civile, në rolet e tyre përkatëse, të parimeve të përbashkëta, normave, rregullave, procedurave vendimmarrëse dhe programeve që i japin formë evolucionit dhe përdorimit të internetit.¹⁶

BIRN Albania e ka hartuar këtë raport për të informuar palët e interesuara mbi mjedisin kompleks dhe rolin që qeverisja e internetit luan në lirinë e medias. Raporti shikon kuadrin ligjor vendës, kontekstin e tregut të medias *online* në Shqipëri, parimet mes të cilave rregullatorët vendës të internetit dhe ofruesit e shërbimeve operojnë, mbikëqyrja që ata ushtrojnë në termat e regjistrimit të domain-eve dhe mbledhjes së të dhënave personale, rregullimin financiar dhe fiskal të medias *online*, dhe si krahasohet kjo me mediat tradicionale. Studimi shikon gjithashtu subvencionimin dhe mbështetjen publike të medias, mënyrën se si rregullohet pronësia dhe konkurrenca, kufizimet në lirinë e shprehjes *online*, mbrojtjen e të dhënave personale, të të drejtave të autorit dhe çështje të tjera etike si dhe parashikimet ligjore për përmbajtje të paligjshme në internet dhe për sigurinë kibernetike.

Ky raport synon të sigurojë një pasqyrë të qartë të të drejtave dhe përgjegjësi, për publikimet *online* në mjedisin e internetit dhe qeverisjes së këtij mjedisi nga institucionet publike, ndërsa nxit një debat me palët e interesuara me synimin e mbështetjes dhe forcimit të lirisë së shprehjes dhe ushtrimit profesional të gazetarisë në internet. Duke parë kompleksitetin e madh të kësaj teme, ky raport nuk është shterues ndërsa studime dhe konsultime të mëtejshme kërkohen për analizimin e rregullimit të internetit dhe lidhjen mes qeverisjes së internetit dhe medias *online*.

Për shkak të natyrës fragmentare të njohurive, mungesës së të kuptuarit të lidhjes mes rregullimit të internetit dhe medias dhe mjedisit rregullator të pazhvilluar mjaftueshëm, ky raport në mënyrë të pashmangshme ka kufizime; më shumë punë nevojitet për të zhvilluar të kuptuarin e plotë të politikës digjitale dhe asaj të medias. Gjithsesi, autorët besojnë se ky është një hap i parë i

¹⁶ World Summit on the Information Society, 2005, Tunis Agenda for the Information Society, <http://www.itu.int/net/wsis/docs2/tunis/off/6rev1.html>

rëndësishëm drejt krijimit të bazës për diskutim mbi rregullimin e medias *online* mbi themele të qëndrueshme.

II. LIRIA E SHPREHJES DHE LIRIA E MEDIAS



Liria e shprehjes së ideve dhe opinioneve nuk është vetëm me rëndësi qendrore për gjendjen e njerëzve por është edhe themelore për një demokraci të suksesshme. Në mënyrë që qeverisja demokratike të lulëzojë, shkëmbimi i lirë i ideve dhe opinioneve pa frikë për ndëshkim ka rëndësi thelbësore. Jo vetëm që liria e shprehjes përbën themelet për shumë të drejta të tjera, të tilla si e drejta e jetës private dhe e drejta për të marrë informacion, por ajo mbron të gjitha llojet e mendimit dhe krijimit – nga arti dhe shkenca te komedia dhe arsimit. Në një mjedis që mbështet debatin dhe dialogun, shkëmbimin e lirë të ideve dhe lirinë e mendimit, qytetarët janë më mirë të përgatitur për të marrë pjesë në një sistem demokratik duke informuar veten, duke vënë para përgjegjësisë ata në pushtet dhe duke advokuar për të drejtat e tyre.

Brenda këtij konteksti, liria e shprehjes ka rëndësi të madhe. Media është kryesore në informimin e qytetarëve, por ajo shërben gjithashtu si një “qen roje” kundër korrupsionit dhe formave të tjera të abuzimit me pushtetin, të cilat gradualisht gërryejnë kohezionin social dhe stabilitetin politik. Megjithatë, nëpër të gjithë botën, liria e shprehjes dhe liria e shtypit janë të kërcënuara. Ngritja e internetit dhe teknologjive të tjera të informimit dhe komunikimit (ITC-ve) ka pasur një ndikim domethënës në demokracinë moderne, aq sa po përshkallëzon tensionet mes shtetasve dhe qeverive si dhe po ekspozon tensione të reja. Ndërsa informacioni rrjedh lirshëm pa “rojet e derës” që ekzistojnë në median tradicionale, komunikimi i drejtpërdrejtë shërben si një urë e fuqishme mes shtetasve dhe zyrtarëve të qeverisë – gjë që nga njëra anë fuqizon shkëmbimin e informacionit dhe transparencën, por gjithashtu lehtëson përhapjen e shpejtë të keqinformimit dhe përmbajtjes së dëmshme.

Pavarësisht fuqisë së tyre, si pozitive ashtu edhe negative, komunikimet *online* nuk janë të ndara

nga ndikimi i vendimmarrjes politike *offline* (ose mungesa e vendimmarrjes). Brenda Shqipërisë, boshllëqe të mëdha ekzistojnë mes respektimit të lirisë së shprehjes dhe mënyrës se si ajo manifestohet në praktikë si në ligj ashtu edhe në akte nënligjore. Ndërsa 82% e 2.88 milionë shqiptarëve janë *online* sipas të dhënave të vitit 2017,¹⁷ interneti ka pasur një ndikim domethënës, por gjithashtu sistemi ligjor shqiptar është në mënyrë domethënëse i pazhvilluar mjaftueshëm në këtë drejtim.

Kuadri ligjor

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka garantuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në nenin 22. Shumë ndryshime e shtesa ¹⁸ i janë bërë kushtetutës që kur ajo u miratua me referendum në vitin 1998, por neni që garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias nuk ka ndryshuar.

Neni 22 parashikon se:

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

Gjithsesi, Kushtetuta shprehet se këto të drejta, krahas të drejtave të tjera themelore, mund të kufizohen. Kufizime të tilla mund të bëhen vetëm për interes publik, apo për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Këto kufizime duhet të jenë proporcionale dhe ato nuk mund të tejkalojnë kufizimet e caktuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), të cilën Shqipëria e

¹⁷ Instituti i Statistikave (INSTAT), 2019, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët 2018-2019, <http://www.instat.gov.al/media/6435/anketa-mbi-p%C3%ABrdorimin-e-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt-2018-2019.pdf>

¹⁸ Ndryshuar me: ligjin nr.9675, datë 13.1.2007; ligjin nr.9904, datë 21.4.2008; ligjin nr.88/2012, datë 18.9.2012, nr.137/2015, datë 17.12.2015 dhe ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016

ka ratifikuar më 1996.¹⁹

Referenca e drejtpërdrejtë të KEDNJ-ja është me rëndësi për dy arsye kryesore:

1. Kjo e bën KEDNJ-në pjesë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shërben si pikë referimi për mbrojtjen e lirisë së shprehjes.
2. Ajo siguron që interpretimi i kufizimeve të të drejtave të njeriut nuk i lihet vetëm institucioneve të Shqipërisë, por ia nënshton ato mekanizmeve interpretuese të KEDNJ-së dhe çështjeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

GJEDNJ-ja ka konsideruar në vijimësi Konventën si një “instrument të gjallë,” dhe ka vendosur konceptin e “konsensusit Evropian” për t’iu referuar nivelit të uniformitetit aktual në kuadrin ligjor të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës (KiE) mbi një temë të caktuar.²⁰

Për më shumë, GJEDNJ-ja nuk është vetëm pjesë e sistemit ligjor shqiptar për shkak të ratifikimit nga Parlamenti Republikës së Shqipërisë, por ka gjithashtu prioritet mbi aktet vendëse sipas Kushtetutës së Shqipërisë.²¹ Për rrjedhojë, institucionet shqiptare dhe gjykatat janë të detyruara të zbatojnë përcaktimet e GJEDNJ-së dhe mekanizmeve të saj interpretuese, të tilla si vendimet gjyqësore.

Liria e shprehjes parashikohet në Nenin 10 të Konventës, e cila shprehet si vijon:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

¹⁹ Ligji nr. 8137, datë 31 korrik 1996, (i ndryshuar), “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

²⁰ Shiko për shembull, <https://www.coe.int/en/web/help/article-echr-case-law>. Ky koncept përdoret, inter alia, për të imponuar standarde të reja ku ka një tendencë të qartë në shumicën e Shteteve Anëtare, duke sjellë për rrjedhojë interpretimin e Konventës.

²¹ Neni 116 në ndërvëprim me nenin 122 të Kushtetutës së Shqipërisë sanksionon hierarkinë e ligjeve ku marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë hierarki më të lartë në krahasim me ligjet vendëse në rast se mes tyre ka një konflikt.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Çështjet gjyqësore të GJEDNJ-së mbi lirinë e shprehjes janë të shumta me vendime të rëndësishme, të cilat garantojnë gjithashtu aksesin në internet, si mjet i komunikimit.

Një nga çështjet më të rëndësishme me interes të posaçëm për qeverisjen e internetit është rasti i *Ahmed Yildirim k. Turqisë* (Aplikimi. 3111/10, 18 dhjetor 2012). Në këtë çështje Gjykata vendosi se neni 10 garantonte lirinë e shprehjes për “çdokënd,” dhe zbatohet jo vetëm për vetë informacionin, por edhe për mjetet e përhapjes së informacionit. Ajo thekson më tutje se interneti është bërë tashmë një nga mjetet kryesore përmes të cilave individët ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes dhe të informimit, ndërsa ky është mjeti kryesor për pjesëmarrje në aktivitete dhe diskutime në lidhje me çështje politike dhe çështje të interesit të përgjithshëm.²²

Instrumente të tjera ndërkombëtare me interes janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, (PNDKP), kjo e dyta është nënshkruar dhe ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991.²³

Neni 19 i DUDNJ-së parashikon se²⁴:

*“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me **çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.**”*

²² Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, 2012, Çështja Ahmet Yildirim v. Turqisë, <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-115705%22%5D%7D>

²³ UN Treaty Body Database, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=2&Lang=EN

²⁴ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

Neni 19 i PNDKP-së parashikon se²⁵:

1. *Secili duhet të ketë të drejtën e mendimit pa ndonjë ndërhyrje.*
2. *Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.*
3. *Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:*

(a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; dhe

(b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”

Gjithashtu në kuadër të integritetit në BE, Shqipëria ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Evropian në vitin 2009.²⁶ Neni 2 i kësaj marrëveshje shprehet se:

“Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe janë përkufizuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si dhe të parimeve të ekonomisë së tregut siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunim Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.”

²⁵ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

²⁶ Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit, publikuar në Gazetën Zyrtare 107, 28 prill 2009, f. 166.

Legjislacioni vendas

Megjithëse legjislacioni shqiptar nuk garanton posaçërisht lirinë e shprehjes për median *online*, të drejta të tilla janë garantuar në legjislacionin vendas për median e shtypur dhe audiovizive.

Në lidhje me lirinë e shtypit në fuqi është Ligji nr. 7756, datë 11 tetor 1993, “Mbi Shtypin” i ndryshuar²⁷. Me këto ndryshime, ligji ka vetëm një nen i cili thotë: “Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet nga ligji.” Megjithëse ky rregullim është konsideruar praktikisht joekzistues,²⁸ ajo mund të interpretohet si një veprim përmes të cilit qeveria ka kufizuar veten nga çdo formë rregullimi të shtypit.

Kur kjo normë interpretohet bashkërisht me normat e sipërpërmendura kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, e lë rregullimin e shtypit në Shqipëri tek standardet më të mira ndërkombëtare.²⁹ Kjo është interpretuar gjithashtu si një tregues se vetë rregullimi i shtypit mbështetur në standardet ndërkombëtare është alternativa më e mirë përkundrejt rregullimit formal.³⁰

Në mënyrë të ngjashme, Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive” parashikon se liria e aktivitetit transmetues audiovizual dhe lirisë së shprehjes janë parimet themelore të rregullimit të medias audiovizive në Shqipëri.

Për sa më sipër, mund të nxjerrim me lehtësi konkluzionin se liria e shprehjes dhe e medias janë qartazi të përkufizuara në Kushtetutën e Shqipërisë si dhe në traktatet dhe marrëveshjet

²⁷ Ligji nr. 7756, datë 11 tetor 1993, “Për shtypin” i ndryshuar me ligjin nr. 8239, datë 3 shtator 1997 <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:8239:03.09.1997>

²⁸ Shiko, për shembull, Rrapo Zguri, Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri, Tiranë, 2017, Instituti Shqiptar i Medias dhe Friedrich Ebert Stiftung, <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf>

²⁹ Të tilla si ato të hartuara nga Këshilli i Europës. (p.sh., <https://rm.coe.int/msi-joq-2018-rev7-e-draft-recommendation-on-quality-journalism-finalis/168098ab76> dhe https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=090000168092dd4d), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (<https://www.osce.org/fom/media-self-regulation>), dhe UNESCO (p.sh., <https://en.unesco.org/themes/communication-and-information>)

³⁰ Gjithsesi, një ide e tillë është kritikuar sepse e ka lënë sistemin ligjor shqiptar pa parashikime të qarta në çështje të përgjegjësisë editorial. Shiko: Irion, K., Cavaliere, P., dhe Pavli, D., 2015. Comparative Study of Best European Practices of Online Content Regulation: Law and policy of online content regulation, in particular defamation online, in the light of Albanian legislative proposals. Studim i komisionuar nga Këshilli i Europës, Amsterdam/Edinburgh/Tiranë, gusht 2015, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168047080a>

ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar si pjesë e sistemit të vet kushtetues dhe ligjor, të cilat qartësojnë, plotësojnë dhe interpretojnë legjislacionin vendës pa asnjë nevojë për rregullim të detajuar shtesë. Pavarësisht mungesës së rregullimit specifik për median *online* dhe publikimet, as në ligjin mbi shtypin dhe as në ligjin mbi median audiovizuale, standardet ndërkombëtare dhe normat kushtetuese, përfshirë garancitë dhe kufizimet e tyre janë të zbatueshme gjithashtu edhe për median *online*.

Kërcënimet ndaj lirisë së medias

Sipas raportimeve të grupeve vendëse të të drejtave të njeriut dhe organizatave ndërkombëtare, liria e medias dhe liria e shprehjes në Shqipëri ka shënuar një përkeqësim të konsiderueshëm gjatë viteve të fundit.³¹ Kjo rënie mund t'i atribuohet, mes tendencave të tjera, përpjekjeve të qeverisë për të miratuar ligje që mund të fuqizojnë një organ administrativ për të censuruar përmbajtjen e medias *online*, përmes gjobave drakoniane, shtimit të proceseve gjyqësore për shpifje kundër gazetarëve dhe mediave, një rritje të sulmeve fizike dhe verbale kundër gazetarëve nga njerëz të veshur me pushtet dhe autoritet politik, rritje të vetë censurës dhe fushatave shpifëse, mungesa e transparencës së institucioneve publike dhe përqendrim i lartë i pronësisë dhe i tregut të reklamave.

Media audiovizuale dhe ajo e shtypur në Shqipëri është e kontrolluar nga një numër familjesh të fuqishme, të cilat kanë interesa të lidhura në tregjet e rregulluara, të tilla si ndërtimi, bankat, lojërat e fatit dhe arsimit të lartë privat.³² Biznesmenët që investojnë në media i përdorin ato në mbështetje të bizneseve të tyre të lidhura dhe lajmet që bien në konflikt me interesat politikë apo ekonomikë të pronarit, shpesh shmangen. Në një mjedis të tillë gazetarët janë të dobët përballë presionit dhe për rrjedhojë, vetëcensurohen. Në kontrast me këtë, mediat *online* janë më të larmishme – shumë prej tyre janë media të reja nën pronësinë e gazetarëve, gjë që lejon për

³¹ Deklaratë e përbashkët, 2019: Gjetjet paraprake të misionit: Liria e Shtypit po përkeqësohet në Shqipëri, <https://europeanjournalists.org/blog/2019/06/21/albania-preliminary-findings-of-joint-freedom-of-expression-mission/>

³² Reporterët Pa Kufi dhe BIRN Albania, 2018, Monnitori i Pronësisë së Medias – Shqipëri, <http://www.mom-rsf.org/en/countries/albania/>

këndvështrime më të larmishme.

Në Indeksin e Lirisë së Medias për vitin 2019,³³ të publikuar nga Reporterë Pa Kufi (RSF), autoritetet shqiptare akuzohet se po abuzojnë me të ashtuquajturën luftë kundër “fake news” për të rritur kontrollin mbi median vendëse. RSF vëren se sulmet verbale dhe fushatat baltosëse janë shtuar nga njerëzit në nivelet më të larta të qeverisjes, ndërsa rastet e sulmeve fizike mbeten të pazgjidhura, duke krijuar një efekt frikësues mbi lirinë e shprehjes. Shqipëria renditet në vend të 84 në 180 vende të vlerësuara nga indeksi i RSF, në rënie me dy pozicione në krahasim me vitin e mëparshëm.

Në dhjetor 2019, qeveria miratoi një seri ndryshimesh ligjore kontroverse në ligjin “Për Komunikimet Elektronike”³⁴ dhe në ligjin “Për Mediat Audiovizive,”³⁵ të cilat synonin të rregullonin përmbajtjen e medias *online* përmes një Këshilli Ankesash – një organ administrativ i etikës brenda Autoritetit të Medias Audiovizive.

Organizatrat vendëse dhe ndërkombëtare të medias kritikuan ashpër projektligjin si një mjet censure³⁶ në duart e qeverisë dhe presidenti vendosi një veto mbi ligjet e i riktheu ata për rishikim parlamentar.³⁷ Ndryshimet u kundërshtuan nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës mes shumë institucioneve të tjera. Shumica e qendrës së majtë e kryeministrit Edi Rama u betua se do të rrëzonte veton e presidentit. Në janar 2020, gjithsesi, parlamenti miratoi vetëm ndryshimet në ligjin “Për Komunikimet Elektronike” dhe pezulloi votimin mbi Ligjin Nr. 97/2013 “Mbi Median Audiovizive” pas një kërkesë nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, te Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, gjerësisht i njohur si Komisioni i Venecias,³⁸ për të vlerësuar

³³ Reporterët Pa Kufi, 2019, Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit: Profili i vendit – Shqipëria, <https://rsf.org/en/albania>

³⁴ Projektligji “Për komunikimet elektronike,” 2019 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20191217153348Komisioni%20i%20Ligjeve%20AKEP.pdf>

³⁵ Projektligji “Për mediat audiovizive,” 2019 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200121101826ligj%20nr%20%2091%20dt%20%2018%2012%202019.pdf>

³⁶ Balkan Insight, 2019, <https://balkaninsight.com/2019/12/18/albania-approves-controversial-media-laws-amidst-protests/>

³⁷ Balkan Insight, 2020, <https://balkaninsight.com/2020/01/13/president-turns-down-albania-controversial-anti-defamation-law/>

³⁸ Komisioni i Venecias është organi këshillues i Këshillit të Evropës për çështjet kushtetuese: https://www.venice.coe.int/WebForms/pages/?p=01_Presentation&lang=EN

këtë legjislacion kontrovers.³⁹

Përmes opinionit të publikuar në qershor 2020, Komisioni i Venecias argumentoi se ndryshimet e ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive”,⁴⁰ të cilat u miratuan nga parlamenti në dhjetor 2019 dhe më vonë u kthyen për rishqyrtim nga Presidenti, nuk duhet të miratohen në formën e tyre aktuale sepse ato mund të kenë efekt frikësues mbi lirinë e medias në Shqipëri.⁴¹

Përkufizimi i medias *online*

Edhe pse media *online* në Shqipëri është bërë një nga burimet kryesore të informimit, nuk ka përkufizim të lirisë së medias të dhënë deri më sot në legjislacionin në fuqi në Shqipëri, as në ligjin e medias audiovizive dhe as në ligjin për tregtinë elektronike.

Ndryshimet në projektligjin “Për Mediat Audiovizive” e përshkruajnë median *online* si publikime elektronike me përmbajtje të formësuar editoriale. Në propozimet për ndryshime në Ligjin nr. 97/2013, një “publikim elektronik” nënkupton faqe interneti me përmbajtje të formësuar editoriale dhe/ose portale që përmbajnë versione elektronike të medias së shkruar dhe/ose informacione mediatike të ofruara për publikun, me qëllim argëtimin, informimin dhe edukimin. Publikimet elektronike të bëra nga individë, të cilat nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim edukimin, argëtimin, apo informimin për publikun, nuk konsiderohen publikime elektronike. Gjithsesi, në opinionin e qershorit 2020 mbi projektligjin, Komisioni i Venecias⁴² theksoi se ky përkufizim i publikimeve elektronike është “tepër i mjegullt dhe tepër i gjerë”. Për më shumë, Komisioni theksoi se është e paqartë nëse ky përkufizim mbulon vetëm mediat apo përfshin edhe blogerët individualë dhe njerëzit me faqe personale në rrjetet e medias sociale, gjë që mund të krijojë shqetësime edhe më të mëdha në lidhje me lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në Shqipëri.

³⁹ Balkan Insight, 2020, <https://balkaninsight.com/2020/01/23/venice-commission-to-judge-over-albania-controversial-media-law/>

⁴⁰ Projektligji “Për mediat audiovizive,” 2019 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200121101826ligj%20nr%20%2091%20dt%20%2018%2012%202019.pdf>

⁴¹ Reporter.al, 2020, <https://www.reporter.al/opinion-i-final-i-venecias-rrezon-ligjin-e-qeverise-per-mediat-online/>

⁴² Komisioni i Venecias, 2020, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF\(2020\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF(2020)007-e)

III. AKSESI NË INTERNET NË SHQIPËRI



Si një mjet i rëndësishëm i ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së informimit, aksesit në internet është identifikuar nga vendimet e GJEDNJ-së si e garantuar nga neni 10 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Megjithëse gjuha shqipe flitet nga rreth 7.5 milionë njerëz, në internet ka një disponueshmëri të gjerë të përmbajtjes në gjuhën shqipe. Sipas renditjes në *A/lexa* të faqeve më popullore në Shqipëri, 7 nga 10 faqet më të vizituara në vend janë me përmbajtje në gjuhën shqipe.⁴³

Për shkak se kuadri kushtetues i Shqipërisë deklaron se kufizimet në lirinë e shprehjes në Shqipëri duhet të jenë proporcionale dhe nuk mund të tejkalojnë kufizimet e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, aksesit në internet, si mjet i komunikimit për të ushtruar lirinë e shprehjes dhe informimit, për rrjedhojë garantohet në kontekstin e kuadrit ligjor vendës.

Sipas një vërtetimi të kryer në vitin 2019 mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit nga familjet dhe individët e kryer nga Instituti i Statistikave,⁴⁴ 82.2% e të gjitha familjeve shqiptare tashmë kanë akses në internet, në krahasim me 80.7% një vit më parë dhe 66.4% më 2016.⁴⁵

Më shumë se gjysma e familjeve që kanë akses në internet (56.6% ose 359,884 familje) kanë akses në internet me brez të gjerë (rrjete kablllore apo të fibrës optike apo të linjës së abonimit digjital asimetrik (ADSL), etj.), ndërsa përqindja e familjeve me akses në internet përmes lidhjeve me brez të gjerë të lëvizshëm (shërbimet e lëvizshme 3G apo 4G) është 88.9% – nga 63% më 2018 dhe 72% më 2017.⁴⁶ Rënia në lidhjet me brez të gjerë përmes telefonisë celulare më 2018 është shkaktuar nga falimentimi i Plus, operatorit të katërt celular të Shqipërisë.

⁴³ Faqet kryesore në Shqipëri, Alexa, 2020, <https://www.alexa.com/topsites/countries/AL>

⁴⁴ INSTAT, 2019, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët 2018-2019 <http://www.instat.gov.al/media/6435/anketa-mbi-p%C3%ABrdorimin-e-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt-2018-2019.pdf>

⁴⁵ International Telecommunications Union (ITU), 2017, https://itu.int/dms_pub/itu-s/opb/pol/S-POL-BROADBAND.19-2018-PDF-E.pdf

⁴⁶ AKEP, 2019, Raporti Vjetor 2019, <https://akep.al/wp-content/uploads/2018/09/AKEP-RAPORT-VJETOR.pdf>

Për më shumë, INSTAT gjeti se 68.8% e të gjithë individëve mes moshës 16 dhe 74 vjeç ka përdorur internetin së paku një herë brenda tre muajve para kryerjes së anketës, nga të cilët 87.1% e të gjithë individëve e përdornin internetin çdo ditë. Në mënyrë domethënëse, pothuajse 96.8% e të gjithë individëve mes moshës 16 dhe 74 vjeç kanë përdorur telefona *smartphone* për të aksesuar internetin, pesë pikë përqindjeje më shumë në krahasim me vitin e mëparshëm. Në mënyrë të ngjashme, 92.3% kanë përdorur ose vijnë të përdorin aplikime mobile, të tilla si Viber, WhatsApp, dhe Skype. Anketa gjeti gjithashtu se 23.7% e të anketuarve aksesuan internetin nga një laptop dhe 6.8% nga një tabletë, një rritje prej 8.5% për laptopët dhe 1.1% për tabletat respektivisht në krahasim me vitin 2018.

Ofruesit e shërbimit të internetit

Bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19 maj 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) përcaktohet si autoriteti kombëtar përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimit të internetit (ISP) në Shqipëri. Sipas nenit 13 të ligjit, çdo sipërmarrës është i lirë të ofrojë rrjete të komunikimeve elektronike dhe shërbime në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e ligjit. Ofrimi i rrjeteve të komunikimit elektronik dhe shërbimeve bëhet bazuar në autorizim nga AKEP.

Ka tre ofrues kryesorë të shërbimeve të teknologjisë së lëvizshme me bazë të gjerë (3G dhe 4G) në Shqipëri: Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom. Shërbimet e para 3G në vend u shfaqën në korrik-shtator 2015 dhe mbulojnë 65% deri në 85% të popullsisë, ndërsa mbulimi me 4G është më i ulët, i vlerësuar në 55.6% të popullsisë dhe kryesisht i përqendruar në zonat urbane. Operatorët kryesorë të shërbimit me brez të gjerë jo lëvizës në Shqipëri janë Albtelecom me 36% të pjesës totale të tregut, Abcom me 18%, ASC/Tring me 14% dhe Abissnet me 10%.

Neutraliteti i rrjetit

Koncepti i neutralitetit të rrjetit i referohet parimit që operatorët, përfshirë ISP-të dhe rregullatorët e qeverisë duhet të trajtojnë të gjithë trafikun në internet në mënyrë të barabartë, duke mos diskriminuar apo tarifuar në mënyrë të ndryshme bazuar në përdoruesin, përmbajtjen, faqen e internetit, platformën, aplikimin, llojin e pajisjes së lidhjes apo mënyrën e komunikimit.⁴⁷ ISP-të menaxhojnë dhe shpërndajnë të dhëna dhe trafik përmes rrjeteve të tyre te përdoruesit fundorë, qoftë kur të dhënat kërkohen nga abonentët, nga ofruesit e përmbajtjes të tillë si Netflix, YouTube, Facebook apo mediat *online*, ashtu edhe në rastet kur komunikimi është i kufizuar mes vetë përdoruesve fundorë. Transmetimi i barabartë i të dhënave të trafikut mes këtyre ofruesve dhe përdoruesve të ndryshëm, duke ndarë aplikimin nga shtresat e protokollit dhe infrastrukturës në internet, nxit novacionin e aplikimeve të pavarura nga ISP-ë duke përmirësuar zgjedhjet për përdoruesit fundorë. Ligji për Komunikimet Elektronike në Shqipëri i referohet neutralitetit të rrjetit në nenin 1 të parimet e ligjit, por nuk ka përcaktime specifike se si duhet të zbatohet ai.

Tarifa zero

Nga e njëjta problematikë e lidhur me parimin e neutralitetit të rrjetit, tarifa zero përkufizohet si praktika e përjashtimit të një trafiku të caktuar në internet nga limitet e paketave, apo ofrimi i aksesit në internet pa kosto financiare nën kushte të caktuara, të tilla si duke lejuar vetëm akses në disa faqe të caktuara interneti apo duke subvencionuar shërbimin nga reklamuesit. Praktika të tilla kanë marrë vëmendje të gjerë në Evropë mes debateve, njësoj si zbatimi i tarifave të ndryshme për lloje të ndryshme të dhënash të kaluara nëpër një rrjet nga një ISP dhe kjo konsiderohet si e papërputhshme me parimin e neutralitetit të rrjetit. Ligji mbi Komunikimet Elektronike në Shqipëri nuk rregullon tarifimin zero dhe kompanitë kanë mundësi të negociojnë apo ofrojnë shërbime të tilla. Një shërbim i veçantë më herët i përjashtuar nga tavanet e të dhënave nga ISP-të në Shqipëri ka qenë Facebook. Mungesa e qartësisë nga qeveria në lidhje me tarifën zero është shqetësuese, veçanërisht për shkak se tarifa zero është e rëndësishme për gazetarinë dhe

⁴⁷ Tim Wu, 2003, Network Neutrality, Broadband Discrimination, http://jthtl.org/content/articles/V2i1/JTHTLv2i1_Wu.PDF

organizatat mediatike. Shpërndarës të fuqishëm të përmbajtjes mund të advokojnë për eliminimin e parimeve të neutralitetit të rrjetit, në mënyrë që ato të fitojnë më shumë pushtet dhe ndikim mbi përmbajtjen, për shembull – zakonisht në kuriz të alternativave më të vogla, iniciativave të reja dhe/ose prodhuesve të pavarur mediatikë, duke dëmtuar në këtë mënyrë lirinë e medias në tërësi.⁴⁸

IV. REGJISTRIMI I ADRESAVE DHE HOSTIMI

WWW.

WWW.

Menaxhimi dhe administrimi i adresave (*domain*) ka rëndësi qendrore në qeverisjen e internetit dhe është një çështje që prek drejtpërsëdrejti lirinë e medias dhe të shtypit në një vend. Bllokimi i adresave është një formë kyçe e censurës e imponuar nëpër botë, për shembull, në rastet kur qeveria ndalon aksesin në informacion dhe detyron të pakënaqurit të heshtin. Shqipëria është anëtar i Komitetit Këshillues Qeveritar (GAC)⁴⁹ të Korporatës së Internetit për Numrat dhe Emrat e Caktuar (ICANN), dhe qeveria shqiptare administron kodin vendës “.al” të domainit të nivelit të parë (ccTLD). Të kuptuarit se si funksionon adresari, në veçanti ccTLDs, ka rëndësi të veçantë për shkak se është një nga fushat më të zhvilluara në politikë bërje në kuadër të qeverisjes së internetit dhe një e tillë ka pasoja të gjera në mënyrën se si interneti aksesohet, zhvillohet dhe përmirësohet.

Regjistrimi i domain-eve në nivelin kryesor “.al”

Në domain është një numër germash (një varg), që përbën një sferë të një autoriteti të caktuar administrativ në internet, por më thjeshtë është themeli në sistemin e adresave të internetit që përdoret për të identifikuar rrjetet dhe burimet e tjera të lidhura me internetin. Emrat domain

⁴⁸ Freedom of the Press Foundation, 2017, Protecting net neutrality is an important press freedom issue, <https://freedom.press/news/protecting-net-neutrality-important-press-freedom-issue/>

⁴⁹ Në vitin 2020, Shqipëria përfaqësohet në GAC nga Vilma Tomco, drejtoreshë e Departamentit të Axhendës Evropiane dhe ICT-së në Këshillin e Ministrave (shiko: <https://gac.icann.org/about/members>).

krijohen në bazë të rregullave dhe procedurave të Sistemit të Emrave Domain (DNS), dhe çdo emër i regjistruar në domainin rrënjë DNS është një nën-domain. Niveli i parë i nën domain-eve konsiderohen domain-et e nivelit të parë (TLD), të cilat mund të jenë domain- gjenerik të nivelit të parë(gTLDs) të tilla si “.com”, “.org.”, ose “.net”, ose ccTLDs të tilla si “.al”apo “.eu”.

Regjistrimi i domaineve në Shqipëri për ccTLD “.al” rregullohet në ligjin “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë,” nr. 9918, datë 19 maj 2008, i ndryshuar.⁵⁰ Institucioni kryesor i administrimit të ccTLD “.al” dhe nën domain-et e saj, është AKEP.⁵¹ Në fund të vitit 2018, kishte 21,537 domaine “.al” të regjistruara në AKEP.

Rregullorja nr. 02, datë 21 shkurt 2008, e ndryshuar, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al”, “.mil.al”, “.edu.al”, “.com.al”, “.org.al” dhe “.net.al””, cakton në detaje rregullat e regjistrimit dhe administrimit të ccTLD “.al”. Kjo rregullore përmban kriteret të përgjithshme dhe rregulla specifike mbi regjistrimin dhe administrimin e “.al” dhe nën domain-eve të saj nga AKEP.

Ajo cakton se emrat e domain regjistrohen “për t’i shërbyer interesit të gjerë të publikut” dhe “për të siguruar në veçanti mbrojtjen e pronësisë intelektuale.” Subjektet që kanë të drejtë të kenë nën pronësi një apo më shumë domain janë: personat juridik publik dhe privat, personat fizikë, dhe individët. Një person fizik mund të regjistrojë deri në pesë adresa “.al” në ccTLD, ndërsa një person juridik privat deri në 15 adresa “.al” ccTLD.⁵² Rregullorja përshkruan në mënyrë specifike se AKEP është i vetmi përgjegjës për administrimin e adresave ccTLD “.al” dhe nën domain-eve të saj,⁵³ dhe për rrjedhojë nuk është përgjegjës për administrimin e domain-eve ndërkombëtare.

Domain-et ccTLD “.al” janë të hapura për të gjitha palët e interesuara pa pasur për detyrim një

⁵⁰ Për një version të konsoliduar shiko: <https://akep.al/wp-content/uploads/images/stories/AKEP/legjislacioni/ligji9918ndryshuar-versioni-publikim-web190313.pdf>

⁵¹ Shiko neni 8, germa K e ligjit Për Komunikimet Elektronike.

⁵² Ju lutem vini re se ky parashkrim nuk është në përputhje me terminologjinë e përdorur nga Qendra Kombëtare e Biznesit në lidhje me ligjet që rregullojnë regjistrin e bizneseve. Termi “person fizik tregtar” duhet të përdoret si ekuivalent me termin “person fizik që ushtron aktivitet ekonomik tregtar” ndërsa termi “person fizik” duhet të kuptohet si individë..

⁵³ Shiko nenin 6, paragrafi 6.1 i rregullores

adresë vendore, ndërsa nën domain-et u jepen vetëm personave me një prani vendore. Kur pronarët e domain-eve, që janë subjekt i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pushojnë së operuari si entitete ligjore dhe hiqen nga regjistri tregtar, ata humbin gjithashtu të drejtën për të përdorur adresën domain.

Kur zgjedh emrin e domain-it, aplikuesi duhet të plotësojë këto detyrime (neni 18):

- Emri nuk duhet të jetë në listën e “emrave të ndaluar”⁵⁴.
- Emri nuk duhet të jetë në listën e “emrave të rezervuar”⁵⁵.
- Emri duhet të jetë në përputhje me rregullat e drejtshkrimit të parashikuar në këtë rregullore.
- Emri nuk duhet të cenojë të drejtat e të tjerëve dhe në veçanti:
 - Të drejtat e autorit (pronësi letrare dhe artistike) dhe/ose pronësi industriale; dhe
 - Ligjin e konkurrencës dhe sjelljen korrekte në biznes dhe në marrëdhënie komerciale.
- Emrat nuk duhet të dhunojnë moralin dhe rendin publik dhe në veçanti nuk duhet të përfshijnë terma që:
 - Dhunojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të drejtat dhe liritë personale dhe të drejtat dhe liritë politike, ekonomike, shoqërore, kulturore si dhe të drejtat e dhëna nga Kushtetuta; dhe
 - Që mund të shkaktojnë dëmtime për zhvillimin e fëmijëve.
- Emrat duhet të jenë të ndryshme nga emrat e ndarjeve administrative dhe territoriale, sipas ligjit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Emrat “e ndaluar” përfshijnë, por nuk janë të kufizuara tek fjalët që kanë kuptim abuzues, fyes dhe/ose racor, fjalë që lidhen me krimet apo me keq bërjet dhe/ose janë në

⁵⁴ AKEP, 2020, Lista e domaineve të ndaluara, https://akep.al/wp-content/uploads/images/stories/AKEP/rregullore/2018/Lista_me_emrat_e_ndaluar_te_domaineve_al_dhe_nendomaineve.pdf

⁵⁵ AKEP, 2020, Lista e domaineve të rezervuara, https://akep.al/wp-content/uploads/images/stories/AKEP/rregullore/2018/Lista_me_emrat_e_rezervuar_t%C3%AB_domaineve_al_dhe_nendomaineve.pdf

kundërshti me sjelljen e mirë. Emra “të rezervuara” konsiderohen emrat që janë subjekt i kushteve specifike që lidhen me identitetin dhe kategorinë e aplikuesit. Emrat e markave tregtare, patentave dhe dizajnovë industriale të miratuara nga autoritetet përkatëse janë të rezervuara për pronarët e regjistruar të markave, patentave apo dizajnove industriale përkatëse. Shembuj të tjerë përfshijnë terma teknikë të internetit, emra të lidhur me aktivitetet dhe operimet e shtetit, emrat e organizatave ndërkombëtare, emrat e ndarjeve administrative dhe territoriale dhe zonave të bazuara në denominimet e tyre popullore apo historike, kulturore apo monumentet natyrore, të përcaktuara nga ligji apo nga aktet nënligjore.

Një listë me emra të rezervuar apo të ndaluar mbahet dhe përditësohet nga AKEP. Gjithsesi, një aplikim mund të refuzohet mbi bazë të tillë edhe nëse emri nuk është në listën e publikuar. Në rast refuzimi, një ankesë e arsyetuar mund të bëhet brenda 30 ditëve nga refuzimi i regjistrimit. Një ankesë mund të dorëzohet gjithashtu edhe nga pronari i një domain-i ccTLD “.al” në rast të mbylljes si rezultat i përfshirjes në listën e domain-eve të ndaluara apo të refuzuara. Ankesa duhet të dorëzohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe duhet të arsyetohet me shkrim. Ankesa ekzaminohet nga Këshilli Mbikëqyrës i AKEP, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe një përgjigje i dërgohet pas kësaj, aplikuesit. Në rast se nuk aplikuesi nuk bie dakord me përgjigjen mund të dërgojë çështjen në një gjykatë kompetente.

Regjistrimi mund të bëhet drejtpërsëdrejti në AKEP, ose përmes regjistrimeve mbi parimin: shërbehet i pari ai që vjen i pari.⁵⁶ AKEP aktivizon një adresë, pasi ekzaminon aplikimin dhe vlerëson se është në përputhje me rregulloren nr. 2, të përkrahur më sipër. Kjo rregullore ka përcaktuar gjithashtu rregulla dhe kushte të detajuara që një kompani duhet të plotësojë në mënyrë që të bëhet regjistruar domain-esh, krahas të gjitha detajeve mbi monitorimin e aktivitetit të tyre. Nuk ka kufizim për numrin e regjistruarve për sa kohë ata plotësojnë kushtet dhe paguajnë tarifat. Format i aplikimit për t’u bërë regjistruar është aneks i rregullores.

⁵⁶ Një listë e regjistruarve të domeineve mund të gjendet këtu: <https://akep.al/2018/12/08/informacion>

Pezullimi i veprimeve për domain-et

Kur ka një mosmarrëveshje mbi regjistrimin, transferimin apo modifikimin e një emri, AKEP mund të lëshojë një urdhër pezullimi të veprimeve sipas kushteve të caktuara. Neni 24 i Rregullores nr. 2 shprehet se AKEP mundet të imponojë pezullimin e veprimeve për adresë në çdo lloj veprimi (p.sh., modifikim, transferim, etj.,) për arsye që përfshijnë, por që nuk janë të kufizuara, në:

- a) Rastet e një procedure administrative, të nisur *ex officio* nga AKEP, përmes një kërkesë të bazuar në këtë rregullore, apo në bazë të një vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës i AKEP, pas rishikimit të një ankese administrative.
- b) Në rastin e një urdhri të lëshuar nga një gjykatë për transferimin e pronësisë ose të pezullimit të veprimeve, mbështetur nga një urdhër ekzekutimi i përkohshëm ose nga vendimi final i autoritetit siç është përcaktuar në nenin mbi transferimet e detyruara.
- c) Në pritje të një vendimi arbitrazhi mbi mosmarrëveshjen përkatëse, në rastet kur aplikanti ka zgjedhur këtë alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Pezullimi ndalon të gjitha veprimet që mund të ndërmerren nga autoriteti përgjegjës (p.sh., AKEP), por pronari i domain-it mundet të vijojë të përdorë domain-in, përveçse kur caktohet ndryshe nga një vendim gjykate. Periudha e pezullimit mbaron me dhënien e vendimit për zgjidhjen e çështjes në themel nga gjykata apo pasi gjykata e arbitrazhit jep vendimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Bllokimi i një emri domain

Bazuar në nenin 25 të Rregullores nr. 2, AKEP mund të bllokojë një adresë domain, nëse e identifikon atë në dhunim të kushteve apo kritereve të përcaktuara në këtë rregullore, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) Rastin e mos identifikimit të suksesshëm të pronarit të domain-it.⁵⁷
- b) Nëse asnjë nga alternativat e komunikimit nuk janë funksionale (të vlefshme) edhe pse kanë kaluar 15 ditë kalendarike nga njoftimi për përditësimin e informacionit.
- c) Në rast të një vendimi gjykate që bllokon emrin domain-in, qoftë ky urdhër i përkohshëm apo vendim final.
- d) Në rastet kur pagesa përkatëse nuk është bërë brenda afatit të përcaktuar.
- e) Në rastet e një vendimi të arsyetuar të Këshillit Mbikëqyrës të AKEP, në fund të një procedure administrative apo një vlerësimi të një ankese.

Mbyllja e një emri domain

Bazuar në nenin 26 të Rregullores nr. 2, mbyllja e një domain-i është një veprim i menjëhershëm dhe i pakthyeshem me përjashtim të rastit kur pronari i domain-it jep prova ligjore të pakontestueshme për të kundërtën, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e mbylljes. Kur një domain mbyllet, ai bëhet i disponueshëm për regjistrim nga një aplikant i ri brenda 30 ditësh. Rregullorja cakton se mbyllja e emrit domain kryhet në rastet e renditura më poshtë:

- a) Kur situata që ka sjellë bllokimin nuk është zgjidhur pas 30 ditësh.
- b) Bazuar në një urdhër gjykate që mandaton bllokimin e një adrese domain, qoftë ky urdhër i përkohshëm apo vendim final. Vendimi duhet të dorëzohet nga pala e interesuar te autoriteti përgjegjës përmes postës.
- c) Në raste të një vendimi arbitrazhi për zgjidhje mosmarrëveshjeje.
- d) Kur emri domain mbart shprehje që janë dukshëm të paligjshme ose është i përfshirë në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar.
- e) Regjistrimi i domain-it në lidhje me pronarin është i paligjshëm pavarësisht përdorimit specifik të tij.
- f) Pronari ka shkelur nene të rëndësishme të rregullores në mënyrë të përsëritur ose

⁵⁷ Fillimisht, para ekzekutimit të masës, pronari i domain-it njoftohet nga AKEP dhe ka 15 ditë kalendarike kohë për të korrigjuar informacionin e dorëzuar gabim sipas kushteve të vendosura në këtë rregullore. Nëse pronari nuk vepron brenda afatit të përcaktuar, AKEP bllokoi domain-in.

pavarësisht paralajmërimeve të bëra nga autoriteti përgjegjës.

- g) Të dhënat e pronarit apo të dhëna të kontaktit me administruesin nuk korrigjohen edhe pas njoftimit të autoritetit përgjegjës për t'i korrigjuar dhe përditësuar ato.
- h) Kur është e pamundur të përcaktohet identiteti i pronarit apo kontakti i administratorit.
- i) Adresa e dhënë nga pronari nuk është ende e vlefshme pas 30 ditësh kalendarike nga bllokimi i domainit.

Pronari i domain-it ka të drejtë të kërkojë mbylljen e domain-it në çdo kohë përmes përdorimit të një formati të caktuar tek autoriteti përgjegjës. Në raste të tilla, ata janë përgjegjës për të gjitha përgjegjësitë që lindin nga ky veprim. Bazuar në faktet dhe arsye, më situata emergjence, kur koha ka rëndësi të veçantë, mbyllja e një domain-i mund të bëhet përmes një vendimi të autoritetit përgjegjës pa njoftim paraprak.

Të dhëna të mbledhura nga pronarët e domain-eve dhe mbrojtja e tyre

Përmes formave standarde të aplikimit të lëshuara përmes regjistruesve të domain-eve, AKEP, si autoriteti përgjegjës, mbledh të dhëna dhe dokumente nga personat fizikë dhe juridikë që regjistrojnë ccTLD “.al”.

Të dhënat e mbledhura përfshijnë statusin ligjor të pronarit, adresën fizike, adresën e-mail dhe numrin e telefonit. Kur pronari i domain-it është individ, AKEP merr një kopje të dokumentit të identifikimit dhe mban të regjistruar numrin e identitetit dhe datën e lëshimit të kartës së identitetit. Nëse pronari i domain-it është biznes, AKEP regjistron gjithashtu një kopje të numrit të identifikimit fiskal (NUIS), adresën dhe të dhënat personale të një kontakti administrativ dhe/ose teknik.

Informacioni i dokumenteve që mbahen apo depozitohen në autoritetin përgjegjës konsiderohen si konfidenciale. Asnjë informacion nuk i transferohet palëve të treta për sa kohë nuk ka një detyrim ligjor për ta bërë këtë ose kur një palë e interesuar kërkon të dhëna të nevojshme për

paraqitjen e një padie në gjykatë gjykatë apo fillimin e një procedurë tjetër për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje.

Në rast të një zgjidhjeje alternative mosmarrëveshjeje, autoriteti përgjegjës do të ofrojë të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me emrin domain-it në diskutim, te organi përgjegjës. Në linjë me këtë kuadër ligjor në fuqi, e drejta e privatësisë së pronarit do të respektohet.

Në një përpjekje për të ndryshuar ligjin 07/2013, “Mbi Median Audiovizive”, për të përfshirë mediat *online* dhe publikimet *online* brenda këtij ligji, qeveria në mënyrë të gabuar dhe të përsëritur deklaroi më 2020 se, krijimi i një regjistri të medias *online* te Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) ishte i nevojshëm për shkak se gjykatat nuk mund të identifikonin adresat dhe kontaktet e njerëzve që kanë regjistruar domain-et për media *online* në çështje gjyqësore civile. Një pretendim i tillë nuk ka bazë. Siç është përshkruar më sipër, autoriteti përgjegjës për regjistrimin e domain-eve në Shqipëri mbledh të dhëna të tilla mbi ccTLD-të dhe të dhënat janë të aksesueshme për personat fizikë apo juridikë që kërkojnë të ngrenë padi.

Kushtet ligjore për shoqëritë tregtare të hostimit

Shoqëritë tregtare që veprojnë në fushën e hostimit janë kryesisht të rregulluara nga përcaktimet e ligjit nr. 9918, “Mbi Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar⁵⁸. Ofruesit janë të lirë të ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimit elektronik përmes (a) një autorizimi të përgjithshëm dhe (b) autorizimi individual, siç është parashikuar në nenin 20 të ligjit nr. 9918.

Autorizimi i përgjithshëm kërkohet në rastet kur ofrimi i rrjeteve dhe i shërbimeve të komunikimit elektronik nuk kërkon burime fundore (numra dhe frekuenca). Një sistem regjistrimi automatik është në funksion dhe autorizimi konsiderohet i miratuar edhe nëse nuk ka përgjigje nga autoriteti. Rrjetet e telekomunikacionit dhe infrastruktura përkatëse mund të ndërtohen duke ndjekur ligjet përkatëse në planifikim urban, ndërtim dhe mbrojtje të mjedisit. Ndërsa ata ndërtojnë/përdorin

⁵⁸ Ligj, Nr.9918 datë:19.05.2008, Flet.Zyrtare Nr.84, Faqe:3673

rrjetet e shërbimeve të telekomunikacionit, ofruesit duhet të sigurojnë rendin publik, sigurinë publike dhe shëndetin publik.

Nuk ka rregulla specifike për kompanitë e hostimit në ligjin nr. 9918, por mbi to zbatohen edhe rregullat e përgjithshme gjithashtu, për sa kohë ata janë të përfshirë në ruajtje dhe përpunim të dhënash. Për shkak se kompanitë e hostimit të faqeve të internetit japin me qira hapësirat e tyre kompjuterike përmes internetit, ato mund të kenë vendndodhje në Shqipëri ose jashtë saj. Për shkak të cilësisë së shërbimit, sigurisë dhe çmimeve më të ulëta, një pjesë e madhe e ccTLD-ve shqiptare janë të hostuara në serverë dhe në kompani të hostimit jashtë vendit. Si të tilla, ato janë subjekte të rregulloreve të tjera, përveç atyre të caktuara nga ligji nr. 9918.

Në disa raste, rregullat e vendosura për kompanitë e hostimit kanë krijuar probleme për botuesit vendës, të cilët kanë parë se si faqet e tyre janë mbyllur nga kompani të tilla për shkak të ankesave për shkelje të të drejtës së autorit. Shumë raste janë raportuar nga individë dhe kompani që kanë plotësuar raporte abuzimi në platforma të ndryshme, të tilla si Facebook, HostGator, apo Cloudflare⁵⁹. Raportet për abuzim mund të lidhen me shkelje të të drejtës së autorit, shkelje të një marke të regjistruar tregtare, etj. Në një rast të njohur të regjistruar në vitin 2016⁶⁰ Carlo Bollino, një gazetar dhe pronar mediash me bazë në Tiranë, u ankua te HostGator LLC – një kompani hostimi me bazë në Huston, Teksas, SHBA – mbi një seri artikujsh të publikuar nga media digjitale shqiptare hashtagalbania.com. Ankesat lidheshin me përdorimin nga ana e Hashtagalbania.com të fotove të Bollinos pa lejen e tij në një seri lajmesh kritike. Bollino pretendonte se lajmet ishin shpifëse dhe u shoqëruan me foto të tij dhe bashkëshortes duke u publikuar pa lejen e tij. Pas kësaj Hashtagalbania.com u hoq nga HostGator. Pronarët e faqes së internetit u ankuan për censurë dhe më pas rifilluan veprimtarinë me një domain tjetër, hashtag.al.

⁵⁹ Netzpolitik.org, 2020, <https://netzpolitik.org/2020/a-german-company-is-responsible-for-the-deletion-of-videos-critical-of-the-albanian-government/>

⁶⁰ Boldnews, 2016, <https://boldnews.al/2016/10/14/bollino-si-veliaj-mbyll-mediat-online/>

V. RREGULLIMI FINANCIAR DHE FISKAL PËR MEDIAN ONLINE



Media *online* në Shqipëri operon mbi të njëjtat rregulla financiare dhe regjim fiskal si të gjitha bizneset e tjera të regjistruara në vend. Nuk ka rregulla specifike fiskale apo financiare apo masa mbështetëse të parashikuara posaçërisht për median *online*.

Individët apo entet ligjore, që dëshirojnë të regjistrojnë dhe operojnë një faqe interneti dhe të angazhohen në transaksione financiare, të tilla si shitja e reklamave apo abonimeve, apo të tilla që mbahen përmes punës së paguar, duhet të operojnë si person juridik, qoftë si sipërmarrje biznesi qoftë si organizatë jofitimprurëse. Ata mundet gjithashtu të operojnë si person fizik, term që i referohet një individi të angazhuar në një zanat të caktuar. Në raste të tilla, ata duhet të regjistrohen – te Qendra Kombëtare e Biznesit, në rastin e tregtarëve dhe shoqërive tregtare dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse në Gjykatën e Tiranës për organizatat jo fitimprurëse. Autoritetet fiskale caktojnë një NUIS dhe entitetet ligjore të regjistruara raportojnë te autoritetet fiskale në përputhje me legjislacionin fiskal. Procedura e regjistrimit për bizneset në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri është e thjeshtë dhe kërkon kohë minimale – me shumë pak burokraci. Regjistrimi i një organizate jofitimprurëse është më kompleks dhe kërkon më shumë kohë. Një media *online* e regjistruar si organizatë jofitimprurëse lejohet të fitojë jo më shumë se sa 20% të të ardhurave të veta vjetore nga shitja e shërbimeve; pjesa e mbetur prej 80% duhet të vijë nga grantet dhe donacionet.

Regjimi fiskal për median *online*, qoftë kjo në formën e sipërmarrjes së biznesit apo organizatës jofitimprurëse është njësoj si për çdo biznes apo organizatë tjetër. Gjithsesi, ka disa dallime mes llojeve të ndryshme të medias kur vjen puna te taksa e paguar mbi reklamën e shitur. Nga viti 2019 e më pas, Ligji mbi Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) specifikon se media audiovizuale (d.m.th., televizionet dhe radiot) mund të shesin reklama për një normë të reduktuar TVSH-je prej 6%; shtypi ka qenë gjithmonë i përjashtuar nga TVSH-ja për reklamat, abonimet dhe shitjet e gazetave. Rregullime të tilla, ndërsa lejojnë median audiovizuale të shesin reklamat me normë të

reduktuar TVSH-je, i lejon atyre në të njëjtën kohë që ti rimbursohet 20% TVSH-së së paguar mbi mallrat dhe shërbimet e blera prej tyre.⁶¹

Në kontrast me median e shtypur dhe atë audiovizuale, regjimi fiskal për median *online* është i njëjtë si për pjesën tjetër të ekonomisë. Reklamat që shiten nga media *online* shoqërohen me TVSH në masën 20%. Edhe reklamat e shitura *online* nga seksionet *online* të medias tradicionale duhet të taksohen me TVSH në masën 20%, pavarësisht se format e tjera të reklamimit kanë shkallë më të ulët TVSH-je.⁶² Një propozim është aktualisht në Kuvend për të ulur TVSH-në për median *online* në masën 6%. Propozimi është dorëzuar në Kuvend, por nuk është shqyrtuar ende nga komisionet parlamentare.⁶³

Për sa i përket ligjeve fiskale shqiptare, kompanitë e medias sociale si Facebook, Google, dhe Twitter krahas medias tjetër *online* të peregjistruar në Shqipëri duhet të kenë një agjent në Shqipëri dhe të paguajnë TVSH njësoj si media *online* vendëse. Kriteria të tilla brenda kuadrit ligjor tatimor rrallëherë zbatohen mbi gjigandët e medias sociale apo kompanitë e tjera ndërkombëtare të medias digjitale, duke sjellë një konkurrencë të pandershme përkundrejt mediave vendëse. Megjithëse nuk ka të dhëna të disponueshme në publik mbi tregun vendës të reklamave të kontrolluara nga kompanitë si Facebook dhe Google, mungesa e taksimit të produkteve të tyre të reklamave i jep atyre *de facto* një avantazh të padrejtë kundrejt mediave *online* vendëse, të cilat taksohen në masën 20%. Kjo është veçanërisht shqetësuese kur qëndrueshmëria financiare dhe ekonomike janë sfidat kryesore me të cilat përballen mediat e sektorit të lajmeve,⁶⁴ një nga shumë sektorët e ekonomisë të trazuar nga ekonomia e internetit⁶⁵ dhe e ndikuar nga dështimi sistemik

⁶¹ Reporter.al, 2018, Qeveria vendos TVSH për reklamat në media në masën 6%, <https://www.reporter.al/qeveria-vendos-tvsh-per-reklamat-ne-media-ne-masen-6/>

⁶² Për më shumë informacion, shiko nenin 49 të ligjit 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar': <https://www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar>

⁶³ Për më shumë informacion shiko propozimin në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë: <http://parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/51400>

⁶⁴ Global Network Initiative, 2020, Threats to Media Sustainability and Freedom of Expression in the Digital Era by Michael J. Oghia & Mira Milosevic, <https://medium.com/global-network-initiative-collection/threats-to-media-sustainability-and-freedom-of-expression-in-the-digital-era-by-michael-j-41fab4d8664a>

⁶⁵ Tom Wheeler, 2018, Time to Fix It: Developing Rules for Internet Capitalism, <https://shorensteincenter.org/developing-rules-internet-capitalism/>

në tregun e medias.⁶⁶

Media *online* në Shqipëri ka qenë shpesh shënjestër e abuzimeve verbale nga politikanët në nivelin më të lartë të pushtetit. Kjo përfshin kryeministrin aktual Edi Rama. Ai akuzoi faqet e internetit për evazion fiskal më tetor 2018. Ndërsa diskutonte ndryshimet në ligjin e medias audiovizive në një postim në Twitter,⁶⁷Rama i cilësoi faqet e internetit si “xhungla *online*” që duhet të legalizohet përmes regjistrimit si biznese në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kryeministri pretendoi gjithashtu se media *online* nuk ka adresa dhe janë fantazma, të përdorura për të shpërndarë materiale shpifëse. Pas deklaratës së Ramës, AKEP publikoi një njoftim për shtyp duke kërcënuar me mbyllje domain-et e 44 faqeve të lajmeve, nëse ata nuk regjistroheshin në autoritetet fiskale. Mbetet e paqartë se si AKEP hartoi listën e faqeve të internetit, të cilat i akuzoi se ishin të paregjistruara në autoritetet fiskale. Gjithsesi, u bë e qartë se lista përfshinte gabimisht media që ishin të regjistruara si organizata jofitimprurëse dhe që paguanin taksa rregullisht si dhe faqe interneti që vepronin si blogje apo përmbledhës lajmesh pa gjeneruar transaksione financiare. I pyetur për të qartësuar se si u hartua lista, AKEP refuzoi të përgjigjet. Gjithsesi, kërcënimi për të mbyllur domain-et e faqeve të lajmeve të paregjistruara si biznese te autoritetet fiskale nuk u materializua kurrë.⁶⁸

Subvencionimet dhe skemat mbështetëse për median publike

Kuadri ligjor shqiptar nuk ofron asnjë formë subvencionimi për gazetarinë dhe median, qoftë për median tradicionale, ashtu edhe për ato *online*. Asnjë ligj nuk jep skema favorizuese publike për sektorin e medias informative në formën e granteve apo kredive me interes zero. Subvencionimet indirekte fiskale në formën e përjashtimit fiskal gjithashtu nuk janë të disponueshme për median tradicionale apo atë *online*.

Megjithëse reklama shtetërore nuk përbën pjesë të konsiderushme në të ardhurat fiskale

⁶⁶ Center for International Governance Innovation, 2019, Public Investments for Global News, <https://cigionline.org/articles/public-investments-global-news>

⁶⁷ <https://twitter.com/ediramaal/status/1050123498352463872>

⁶⁸ BalkanInsight, 2018, <https://balkaninsight.com/2018/10/15/albania-communication-authority-threatens-website-closure-10-15-2018/>

për median tradicionale dhe ato *online*, ajo mund të luajë një rol të rëndësishëm në formën e subvencionimit indirekt dhe të kthejë linjën editoriale në favor të qeverisë, institucioneve publike apo korporatave në pronësi publike. Institucione të tilla mund të transferojnë para te mediat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte përmes agjencive të reklamave apo palëve të treta. Këto transferime janë veçanërisht problematike, për shkak se kanë formën e subvencionimeve në një mjedis ku nuk ka rregulla të qarta për shpërndarjen e reklamave shtetërore. Reklamat shtetërore nuk shpërndahen në mënyrë të drejtë mes mediave të ndryshme në Shqipëri – qofshin këto audiovizive, print apo *online*. Nuk ka mekanizma për të garantuar që reklamat shtetërore të bazohen në të dhënat mbi ndjekshmërinë apo lexueshmërinë. Rregullat e thjeshta të prokurimit të reklamave shtetërore lënë shumë hapësirë për abuzime⁶⁹, veçanërisht për shkak se procedura lejon që kontratat reklamuese t'i jepen agjencive të reklamave që më pas mundet t'ia kalojnë kontratat, pa detyrim për të respektuar ndonjë kriter të qartë. Asnjë organ zyrtar nuk është i mandatuar për të monitoruar procesin. Një problem tjetër me reklamat është se ato shpesh komisionohen në kuadër të projekteve të ndryshme të zbatuara nga qeveritë qendrore apo vendore dhe që nuk janë subjekt i asnjë rregulli prokurues.

Kuadri ligjor i tregtisë elektronike për median *online*

Megjithëse pak media *online* ofrojnë shërbime abonimi, ky model i gjenerimit të të ardhurave pritet të fitojë peshë në të ardhmen.⁷⁰ Në këtë drejtim, transaksionet financiare elektronike të kryera *online* për mediat me abonim rregullohen nga ligji nr. 10128/2009 (i ndryshuar) “Për Tregtinë Elektronike”, i cili përcakton rregulla mbi:

- Tregtinë elektronike dhe shërbimet e shoqërisë së informacionit;
- Mbrojtjen e palëve në transaksione të tilla;

⁶⁹ Instituti Shqiptar i Medias, 2019, “Tregu i Reklamave në Median Shqiptare”, <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/01/Tregu-i-Reklamave-ne-Median-Shqiptare.pdf>

⁷⁰ Instituti Shqiptar i Medias, 2018: “Peizazh i medias online në Shqipëri,” http://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online.pdf

- Ruajtjen e privatësisë së të dhënave të palëve në transaksione të tilla;
- Lëvizjen e lirë të shërbimeve të informimit; dhe
- Përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit.

Përkufizimi i “shërbimeve të shoqërisë së informacionit” përcaktohet në ligj si të tilla që përfshijnë shërbimet e ofruara në distancë përmes mjeteve elektronike me kërkesë të marrësit, përkundrejt kompensimit. Abonimet e medias *online* e të tjera të shitura përmes internetit me pagesa elektronike janë të klasifikuara në këtë kategori dhe rrjedhimisht duhet të plotësojnë kushtet dhe specifikimet e këtij ligji.

Ligji zbatohet te të gjitha shërbimet e ofruara në mënyrë elektronike, për personat natyrorë ose për personat juridikë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pa iu referuar në mënyrë specifike medias *online*.⁷¹ Ofruesi i shërbimeve duhet t’i japë autoriteteve dhe marrësve të shërbimit një sasi minimale informacioni, përfshirë emrin e vet tregtar, adresën dhe selinë ligjore, faqen e internetit dhe adresën e e-mailit si dhe të dhënat mbi regjistrimin e kompanisë.

Transaksionet e kryera elektronikisht konsiderohen të ekzekutuara në mënyrë të vlefshme në bazë të ligjit për tregtinë elektronike në rast se përmbushin kërkesat e Kodit Civil⁷² dhe ligjit “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”⁷³ (9002/2008).⁷⁴

AKEP është përgjegjës për mbikëqyrjen e respektimit të ligjit “Për Tregtinë Elektronike”, ndërsa mbrojtja e konsumatorëve bëhet nga Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë krahas organeve të tjera siç janë përcaktuar në Ligjin “Për Mbrojtjen

⁷¹ Kini parasysh këto përjashtime: shërbimet e noterisë publike apo të ngjashme në zbatim të autoritetit publik; përfaqësimit të palëve të treta para gjykatave apo autoriteteve të tjera; aktivitete në lidhje me pjesëmarrjen në baste, lotari, lojëra elektronike apo lojëra fati dhe kazinosh; marrëdhëniet ligjore me autoritetet fiskale, mbrojtja e të dhënave personale apo marrëveshjet e qeverisura nga ligji Për Konkurrencën.

⁷² Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë: <https://qbz.gov.al/preview/f010097e-d6c8-402f-8f10-d9b60af94744>

⁷³ Ligji nr. 9002/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, http://www.erru.al/doc/ligji_9902_per_mbrojten_e_konsumatoreve.pdf

⁷⁴ Ky ligj nuk zbatohet për kontratat për të krijuar apo fshirë të drejta mbi pronën e patundshme; kontrata që kërkojnë me ligj pjesëmarrjen e gjykatës, autoritetit publik apo shërbimeve profesionale publike; kontratave të qeverisura nga Kodi i Familjes; veprimet e qeverisura nga kapitulli i Kodit Civil që rregullon çështje të trashëgimisë testamentare; dhe kontratat financiare apo të sigurimit.

e Konsumatorëve”, të tilla si: Avokati i Popullit, arbitrazhi, gjykata administrative, etj.

Ligji “Për Tregtinë Elektronike” përcakton penalitetet e zbatueshme në rast të shkeljes së kërkesave të ligjit. Gjohat që mund të përdoren janë deri në 200,000 lek (1,613.40 euro).

VI. PRONËSIA DHE KONKURRENCA



Gazetarët dhe industria e medias informative si e tërë përballen me kërcënime të pa precedentë në ndryshimin e mjedisit të informacionit me sfida ekonomike dhe të tregut që janë disa nga – nëse jo *më* – të rëndat në planet. Panorama e tregut për media financiarisht të qëndrueshme, përkundrejt pagesës dhe të pavarura të lajmeve është duke u megjulluar.⁷⁵ Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe të Medias (ECPMF) me bazë në Lajpcig ka vërejtur: “Media e pavarur dhe gazetaria e lirë është e mundur vetëm nëse kompanitë mediatike janë ekonomikisht të pavarura dhe financiarisht të qëndrueshme.”⁷⁶

Industria e medias është një nga shumë sektorë ekonomikë të trazuar nga “kapja e medias”⁷⁷ – ku qeveritë, elitat dhe qendrat e pushtetit përdorin sistemet e medias për interesa të vetat – si dhe nga ekonomia e internetit.⁷⁸ Nëse organizatat e medias dhe gazetarët nuk mund të plotësojnë nevojat e tyre financiare bazë, apo duhet të ridrejtojnë gjithnjë e më shumë burimet e tyre të pakta për të mbrojtur veten nga kërcënimet nga sfera digjitale, përfshirë “botet e rrjetit”,⁷⁹ “fermat e trollëve”

⁷⁵ Reuters Institute, 2019, Digital News Report 2019, https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/sites/default/files/inline-files/DNR_2019_FINAL.pdf

⁷⁶ European Centre for Press and Media Freedom, 2018, Media freedom in Europe: CODE RED, <https://ecpmf.eu/archive/news/press-releases/media-freedom-in-europe-code-red.html>

⁷⁷ The National Endowment for Democracy, 2017, In the Service of Power: Media Capture and the Threat to Democracy, <https://cimaned.org/publication/media-capture-in-the-service-of-power/>

⁷⁸ Tom Wheeler, 2018, Time to Fix It: Developing Rules for Internet Capitalism, <https://shorensteincenter.org/developing-rules-internet-capitalism/>

⁷⁹ Një bot është një program kompjuterik që kryen detyra të automatizuara në internet. Për më shumë shiko: <https://gijn.org/2018/11/05/how-to-identify-bots-trolls-and-botnet>

të sponsorizuar nga shteti,⁸⁰ algoritmet e platformave dhe demonetizimin e përmbajtjes, është një sfidë gjithnjë e më e madhe trajtimi i shqetësimeve të tjera të larmishme me të cilat përballen gazetarët si dhe e gjithë demokracia – nga siguria te censura.

Konsolidimi i pronësisë, konkurrenca dhe aksesimi në treg, luajnë një rol kyç në përkeqësimin e situatës sakaq të vështirë të gazetarisë dhe të sektorit të medias informative. Ndërsa gjithnjë e më shumë nga jeta jonë dhe pasojat e vendimeve tona transformohen në të dhëna, mbledhja e papenguar dhe përdorimi i të dhënave tregtare dhe personale nga disa kompani ka krijuar monopole virtuale mbi të dhënat dhe pengesa për funksionimin e lirë të tregjeve digjitale. Për rrjedhojë, kompanitë teknologjike me vlerë shumë miliarda dollarë konkurrojnë drejtpërsëdrejti me gazetarët dhe organizatat e medias për vëmendje, besnikëri dhe ndërveprim me përdoruesit, si dhe për xhepat e çdo kompanie reklamuese që dikur mbështesnin vetëm modelin e biznesit të medias tradicionale. Që ta përmbledhim këtë, pengesat për të hyrë për shërbimet e reja novatore janë duke u rritur vazhdimisht, ndërsa hapësira për shërbime publike, përfshirë gazetari në shërbim publik, po zvogëlohet vazhdimisht.

Kriza e COVID-19 po e kthen një situatë kaq të keqe, në një situatë edhe më të keqe, ndërsa pasojat e saj ekonomike kanë goditur në një kohë kur media informative nuk ka qenë kurrë më e dobët.⁸¹

Për rrjedhojë, përcaktimi i politikave të shëndosha për mbrojtjen e konkurrencës, dhe kërkesat për transparencë në pronësi janë të nevojshme për të zgjidhur krizën më të gjerë me të cilën përballen gazetarët dhe sektori i medias informative,⁸² ndërsa këto ndihmojnë gjithashtu fuqizimin e mjeteve të tjera pro demokratike dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut *online*, të tilla si liria e mendimit dhe e shprehjes, liria për akses në informacion dhe aftësia për të marrë narrativë të

⁸⁰ Institute for the Future, 2018, State-Sponsored Trolling: How Governments Are Deploying Disinformation as Part of Broader Digital Harassment Campaigns, https://iftf.org/fileadmin/user_upload/images/DigIntel/IFTF_State_sponsored_trolling_report.pdf

⁸¹ Reuters Institute, 2020, What will the coronavirus pandemic mean for the business of news? <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/risj-review/what-will-coronavirus-pandemic-mean-business-news>. Për më shumë informacion shiko: https://freedex.org/wp-content/blogs.dir/2015/files/2020/04/A_HRC_44_49_AdvanceEditedVersion.pdf dhe <https://gfmd.info/emergency-appeal-for-journalism-and-media-support-2/>

⁸² UNCTAD, 2019, Restoring Competition in “winner-took-all” digital platform markets, https://unctad.org/en/PublicationsLibrary/serp-2019d12_en.pdf

ndryshëm.⁸³

Debatet në nivel botëror, që po zhvillohen nëpër parlamente, agjenci rregullatore dhe qarqe politike po konsiderojnë ndikimin më të gjerë që kanë ekonomia digjitale, rregullimet nga qeveria dhe politikat e platformave digjitale në të gjithë shoqërinë. Por, këto debate shpesh anashkalojnë apo minimizojnë gazetarinë dhe median informative, si dhe pasojat që ka fuqia në treg e platformave digjitale në aksesin e lajmeve cilësore. Nga dezinformimi te përgjegjësia e ndërmjetësve, çështjet e lidhura me përmbajtjen duhet gjithashtu të shihen brenda një konteksti më të gjerë të sfidave të lidhura me tregun, ndërsa duhet të bëhet një dallim i qartë mes rregullimit të përmbajtjes dhe rregullimit të tregut.

Shembujt për praktikën më të mira nga të cilat Shqipëria mund të marrë frymëzim është politika e konkurrencës së Komisionit Europian⁸⁴, Komisioni i Konkurrencës dhe i Mbrojtjes Konsumatore të Australisë (AÇC), Digital Platforms Inquiry⁸⁵, nga puna e kryer nga grupi advokues me bazë në Shtetet e Bashkuara Free Press⁸⁶, dhe analizat dhe rekomandimet e ofruara nga Raporti Final i Komitetit Stigler mbi Platformat Digjitale, kryer nga Qendra George J. Stigler “Për Studimet e Ekonomisë dhe Shtetit në Universitetin e Çikagos”⁸⁷, veçanërisht ata të Komitetit për Studimin e Strukturës së Tregut të Platformave Digjitale dhe Nën-komiteti Antitrust⁸⁸ dhe më specifikisht, Komiteti i Medias⁸⁹.

⁸³ Article 19, 2018, How can competition law help to secure freedom of expression on social media? <https://article19.org/resources/how-can-competition-law-help-to-secure-freedom-of-expression-on-social-media/>

⁸⁴ European Union, 2019, Competition Policy for the digital era, <https://ec.europa.eu/competition/publications/reports/kd0419345enn.pdf>

⁸⁵ Australian Competition and Consumer Commission's (ACCC), 2019, Digital Platforms Inquiry, <https://accc.gov.au/focus-areas/inquiries/digital-platforms-inquiry/final-report-executive-summary>. Për një krahasim më të vlefshëm mes përfaqësuesve australiane dhe asaj të BE-së mund të klikoni këtu: <https://gfmd.info/digital-platforms-regulation-and-media-sustainability-a-lesson-for-europe-from-down-under/>

⁸⁶ <https://www.freepress.net/issues/media-control>

⁸⁷ <https://research.chicagobooth.edu/-/media/research/stigler/pdfs/digital-platforms---committee-report---stigler-center.pdf?la=en&hash=2D23583FF8BÇ560B7FEF7A81E1F95C1DDC5225E>

⁸⁸ <https://research.chicagobooth.edu/-/media/research/stigler/pdfs/market-structure-report.pdf>

⁸⁹ <https://research.chicagobooth.edu/-/media/research/stigler/pdfs/media---report.pdf?la=en&hash=B9C175BCDBF29606704740B23D290CD447D1F3BA>

Publikimi i detajeve të pronësisë së medias *online*

Kërkime të kryera nga BIRN Albania tregojnë se faktorët më të mëdhenj që ndikojnë linjën editoriale të medias në Shqipëri janë interesat politikë dhe ekonomikë të pronarëve të medias, të cilët nga ana e tyre ushtrojnë presion mbi shumë gazetarë që të vetëcensurohen.⁹⁰ Për rrjedhojë, transparenca e pronësisë së medias, pavarësisht llojit të mediumit (p.sh., print, audiovizive, digjitale etj.), është e rëndësishme për publikun për të identifikuar çdo anësi politike dhe ekonomike që mund të ndikojë raportimin mbi një temë apo çështje e caktuar si dhe të vërejë rastet e konfliktit të interesit.

Legjislacioni shqiptar nuk ofron kushte specifike për publikimin e pronësisë së mediave. Autoriteti i Medias Audiovizive mbledh dhe publikon të dhëna për transmetuesit, por ligji nuk përfshin ndonjë kriter specifik për transparencën e pronësisë në përgjithësi, e akoma më pak për median *online*. Më 2018, BIRN Albania dhe Reporterë Pa Kufi përmes Monitorit të Pronësisë së Medias publikuan një bazë të dhënash mbi mediat më të rëndësishme në vend.⁹¹ Kjo bazë të dhënash është e lehtë në përdorim, por nuk reflekton ndryshimet më të fundit mbi pronarët dhe administratorët e medias.

Legjislacioni shqiptar gjithashtu nuk përfshin ndonjë kriter specifik për publikimin e pronësisë së medias digjitale, si vendëse ashtu edhe ndërkombëtare. Shumica e informacionit në lidhje me pronësinë e kompanive të medias të regjistruara te autoritetet fiskale në Shqipëri ofrohet nga Regjistri Tregtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit.⁹²

Regjistri është i disponueshëm publikisht, por mund të jetë e vështirë për publikun të identifikojë pronarët për shkak se disa media mund të mos jenë regjistruar si një biznes. Nëse media është e regjistruar, gjithsesi kompania mund të ketë një emër të ndryshëm nga entiteti *online*, duke komplikuar më tutje përpjekjet për të hetuar pronësinë e saj. Kur media *online* drejtohet nga një organizatë jofitimprurëse, publiku do të përballet gjithashtu me vështirësi në aksesimin e

⁹⁰ BIRN Albania, 2015, Të mbyllësh një sy ndaj lajmit: Vetëcensura në median shqiptare, <https://birn.eu.com/Wp-content/uploads/2017/05/Report-on-self-censorship-in-the-Albanian-media.pdf>

⁹¹ Reporterët Pa Kufi dhe BIRN Albania, 2018, Monitori i Pronësisë së Medias – Shqipëri, <http://www.mom-rsf.org/en/countries/albania/>

⁹² <http://qkb.gov.al/home/>

informacionit për administratorët dhe për bordin e drejtorëve. Për të kërkuar një informacion të tillë, palët e interesuara duhet të njohin emrin e organizatës dhe të dorëzojnë një kërkesë për të drejtë informimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se një informacion i tillë nuk është i disponueshëm *online*.

Kuadri ligjor shqiptar trajton shumë pak çështjen e pronësisë dhe përqendrimit të tregut në median audiovizuale,⁹³ një pjesë e të cilit është sfiduar nga Gjykata Kushtetuese dhe nuk është më në zbatim.⁹⁴ Gjithashtu nuk ka parashikime apo rekomandime në lidhje me përqendrimin vertikal apo horizontal të pronësisë në *median online* në Shqipëri.

Konkurrenca në *median online*

Ligji nr. 9121, datë 28 korrik 2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,⁹⁵ kërkon që njësitë e biznesit të respektojnë rregullat për konkurrencë të lirë dhe efikase në tregun shqiptar. Institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit është Autoriteti i Konkurrencës. Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” është i zbatueshëm për të gjithë sektorët e ekonomisë së Shqipërisë si dhe për të gjitha ndërmarrjet, qoftë private ashtu edhe publike, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend. Kjo përfshin edhe ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin e tyre jashtë vendit, por që në fund kanë ndikim në tregun vendës. Nuk ka rregullime specifike për ndonjë sektor të caktuar ekonomik në ligj; për rrjedhojë, media elektronike bie nën juridiksionin e Autoritetit të Konkurrencës si një biznes i zakonshëm.

Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës përqendrohet në identifikimin e (a) marrëveshjeve të ndaluara (tip karteli); (b) abuzimi me pozitën dominuese në treg dhe (c) përqendrimet e ndërmarrjeve. Këto aktivitete janë nën mbikëqyrje për të gjitha ndërmarrjet që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë

⁹³ Ligji nr. 97/2013, “Për median audiovizive,” i ndryshuar: <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/LIGJI-Nr-97-2013-PER-MEDIAT-AUDIOVIZIVE-NE-REPUBLIKEN-E-SHQIPERISE.pdf>

⁹⁴ Shiko vlerësimin e situatës ligjore në Monitorin e Pronësisë së Medias në Shqipëri: https://albania.mom-rsf.org/uploads/tx_lfrogmom/documents/237.pdf

⁹⁵ Ligji nr. 9121, datë 28 July 2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës,” i ndryshuar: http://www.caa.gov.al/uploads/laws/Ligji_Per_mbrojtjen_e_konkurrences_i_Perditesuar.pdf

apo të tërthortë treg – gjë që përfshin të gjitha ndërmarrjet e regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë – por edhe ndërmarrje që veprojnë jashtë vendit, nëse ndikimi i aktivitetit të tyre ndihet edhe në tregun e brendshëm. Kjo mund të përfshijë në teori edhe kompani si Facebook dhe Google, të cilat janë të regjistruara jashtë vendit nëse kapin pjesë të mëdha të tregut të reklamave në Shqipëri.

Liria e shprehjes nuk është një objektiv më vete i politikës së konkurrencës, por mund të jetë një faktor që mund të merret në konsideratë kur autoritetet e konkurrencës ndërhyjnë në tregun e medias. Shqetësimi më i madh në raste të tilla është përqendrimi i medias, si vertikal ashtu edhe horizontal, abuzimi me të cilin zakonisht konsiderohet si dëmtuese për konkurrencën.

Ligji për konkurrencën ushtron kontrollin e vet në dy mënyra: *ex-ante*, duke kontrolluar bashkimet dhe blerjet (të njohura edhe si përqendrimet në treg), dhe *ex-post*, duke ndaluar abuzimin me një pozicion dominues në treg. Në rastin e dytë, një shkallë e lartë e përqendrimit në treg është një tregues i përdorur për të caktuar pozicionin dominues të një kompanie në treg, por nuk është faktori i që merret në konsideratë. Pengesat për të hyrë, veçanërisht ato teknike, ligjore dhe financiare merren parasysh gjithashtu si faktorë të rëndësishëm.

Në lidhje me rregullimin *ex-ante*, ligji mbi konkurrencën thotë se bashkimet dhe përthithjet apo përqendrimet në treg konsiderohet se kanë ndodhur kur ka një ndryshim në kontrollin e qendrueshëm si rrjedhojë e: (a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra; (b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjese të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm; ose (c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit.

Sipas ligjit, kontrolli mund të përfitohet nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat më vete ose të kombinuara dhe duke marrë parasysh rrethanat e faktit ose të ligjit, krijojnë

mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje dhe në veçanti nga: (a) e drejta e pronës ose e drejta për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje; dhe (b) të drejtat ose kontratat, që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje.

Gjithsesi, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson përqendrimet në treg vetëm kur plotësohen nivelet e mëposhtme të xhiros: (a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është më shumë se 7 miliardë lekë (afërsisht 50 milionë euro) *dhe* xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm është më shumë se 200 milionë lekë (afërsisht 1.4 milionë euro); ose (b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë (afërsisht 2.8 milionë euro) dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë. Bazuar në informacionin më të fundit të disponueshëm, operatorët e tregut të medias *online* duken se në përgjithësi bien poshtë këtyre pragjeve. Gjithsesi, nëse ato janë pjesë të kompanive më të mëdha mediatike, ato mund të jenë subjekt i rishikimit të bashkimeve dhe blerjeve nga Autoriteti i Konkurrencës. Në fund, mungesa e qartësisë është problematike dhe duhet të korrigjohet.

Nëse këto pragje plotësohen, Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë nëse bashkimi rrezikon të kufizojë në mënyrë domethënëse konkurrencën në treg apo në pjesë të tregut, veçanërisht si pasojë e krijimit apo fuqizimit të një pozicioni dominues – duke përforcuar më tutje përqendrimin në treg është një nga elementët kryesorë, ndonëse jo i vetmi që shqyrtohet. Nga informacioni më i mirë i disponueshëm, Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar përqendrimet e medias vetëm nga këndvështrimi i biznesit dhe nuk ka përdorur ndonjë metrikë tjetër, të tillë si liria e shprehjes apo pluralizmi i medias si tregues.

Në një nga vendimet më të fundit në tregun shqiptar të medias, vendimi nr. 653 i 17 tetorit 2019, i Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Autorizimin e Përqendrimit të Realizuar përmes Blerjes së Kontrollit të ABC News SHA nga z. Aleksandër Frangaj dhe znj. Alba Ginaj”, Autoriteti mori në konsideratë pronësinë mbi media të ndryshme nga subjektet, por pa ofruar ndonjë detaj mbi

tregjet specifike (shikuesit, reklamuesit, etj.) apo duke konsideruar natyrën e veçantë të ABC News Albania, si një transmetues 24 orësh vetëm informativ dhe jo si media gjeneraliste⁹⁶.

VII. KUFIZIMET E LIRISË SË SHPREHJES NË INTERNET



Megjithëse Kushtetuta e Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut njeh të drejtat themelore të lirisë së shprehjes dhe të medias, ato lejojnë gjithashtu edhe kufizime proporcionale. Kufizime të tilla duhet të bëhen me ligj dhe duhet të jenë në interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Në Shqipëri, kufizimet kryesore për lirinë e shprehjes *online*, që rregullohen nga ligji përfshijnë shpifjen dhe fyerjen, gjuhën e urrejtjes, materialet e mbrojtura nga të drejtat e autorit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Institucionet kryesore të ngarkuara me mbikëqyrjen e këtyre kufizimeve janë gjykatat penale dhe civile, Komisioneri Kundër Diskriminimit dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe organet vetë-rregulluese, të tilla si Këshilli Shqiptar i Medias.

Shpifja dhe fyerja

Shpifja në Shqipëri është ende një kundërvajtje penale e dënueshme me gjobë. Kodi Penal aktual e përkufizon shpifjen si: “Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit”. Dënimi varion nga 50,000 në 1,500,000 lekë (400–12,000 euro). Kodi Penal u ndryshua në vitin 2012 duke hequr dënimin me burg deri në dy vjet, për shpifjen.

Kodi Civil⁹⁷ e trajton shpifjen si një dëm jo-kontraktor dhe jo-monetar të pësuar nga paditësi. Në

⁹⁶ Autoriteti i Konkurrencës, 2020: Raporti Vjetor 2019, [https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20200302103507All-Raporti-2019-20200221%20\(2\).pdf](https://www.parlament.al/Files/Kerkese/20200302103507All-Raporti-2019-20200221%20(2).pdf)

⁹⁷ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë: <https://qbz.gov.al/previeë/f010097e-d6c8-402f-8f10-d9b60af94744>

të njëjtën kohë, një kompromis në vitin 2012 mes partive kryesore politike bëri që të kufizohet imuniteti parlamentar në rastin e shpifjes. Neni 73 i Kushtetutës tashmë parashikon se: “Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.”

Bazuar në të dhëna të mbledhura nga BIRN me anë të një kërkesë për të drejtë informimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka trajtuar 13 raste penale të shpifjes dhe 62 raste civile ndërmjet viteve 2018 dhe 2019. Pothuajse gjysma e këtyre proceseve kanë shënjestruar gazetarë dhe media. Ka pasur mbi 240 gjyqe, civile dhe penale për shpifje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë përgjatë dekadës së fundit, nga të cilat, gjysmat kanë qenë kundër mediave. Shumica e të tjerave ishin pretendime për shpifje mes politikanëve mbi deklarata publike – pjesa më e madhe e tyre të shkruara në median sociale. Shumat e mëdha të kërkuara dhe ato të dhëna nga gjykatat tregojnë një tendencë të dukshme për ulje përgjatë viteve. Pretendimet nga paditësit dhe dëmshpërblimet e caktuara nga gjykatësit ishin më të larta në fillim të dekadës, duke arritur në 40 milionë lekë (319,433 euro) në një rast, me një tendencë për rënie të regjistruar nga gjykatat së fundmi.

Kodi penal

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (neni 119, i ndryshuar më 2012) parashikon se fyerja e qëllimtë ndaj një personi është kundërvajtje penale dhe dënohet vetëm me gjobë nga 50 mijë deri në 1 milionë lekë. Kur një akt i tillë kryhet në publik, në dëm të shumë njerëzve apo përsëritet më shumë se një herë, dënohet me gjobë nga 50,000 në 3 milionë lekë.

Neni 120 i Kodit Penal parashikon se përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.

Kodi Civil

Neni 625 i kodit civil parashikon se një person që ka pësuar dëm të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet kur:

- ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- është cenuar e drejta e emrit;
- është cenuar respektimi i jetës private;
- është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.

Kodi Civil (neni 647/a i shtuar në vitin 2012) ka caktuar gjithashtu edhe elementët që duhet të ketë parasysh gjykata kur përcakton përgjegjësinë civile. Sipas rastit konkret, gjykata duhet të ketë parasysh edhe faktorët e mëposhtëm:

- mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;
- shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;
- format dhe shkallën e fajësisë;
- faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;
- faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;
- faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;
- faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;
- faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione

shtetërore a kandidatë për zgjedhje;

- kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si, bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;
- faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi;
- faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktesit të dëmit.

Gjuha e urrejtjes

Në raportin për Shqipërinë të vitit 2018,⁹⁸ Komisioni European vërejtë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër grupeve të ndryshme shoqërore përbën një shqetësim në rritje, në veçanti për shkak të rritjes në median audiovizuale dhe sociale gjatë viteve të fundit. Raporti i vitit 2017, “Monitorimi i Gjuhës së Urrejtjes dhe Diskriminimi në Median Online”,⁹⁹ dokumenton se, gjatë periudhës së monitorimit nga nëntori në dhjetor 2017, 21 për qind e artikujve të publikuara në median *online* përmbanin gjuhë urrejtjeje të drejtuar kundër grupimeve apo bashkësive të caktuara, në veçanti romëve dhe minoriteteve të tjera etnike, bashkësisë LGBTQ+ dhe grave.¹⁰⁰

Instrumenti kryesor ligjor kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri është përshkrimi i disa krimeve dhe kundërvajtjeve të lidhura me të në Kodin Penal.¹⁰¹ Përdorimi i sistemeve kompjuterike si mjet operimi është i përshkruar në mënyrë specifike në disa nga këto dispozita. Duhet të theksohet se, në nenin 50/j të Kodit Penal konsiderohet si rrethanë rënduese nëse një krim kryhet për shkak

⁹⁸ Dokument pune i Komisionit: Raporti për Shqipërinë 2018, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

⁹⁹ ProLGBT, 2017, Monitorimi i Gjuhës së Urrejtjes dhe Diskriminimit në Median Online, <https://www.historia-ime.com/wp-content/uploads/2018/01/Raportin-e-Plotë.pdf>

¹⁰⁰ Raport mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri. Gratë nëpër Shqipëri përballen me ngacmime të shumta dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore offline, gjë që pa dyshim ka kaluar edhe online: https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2019/05/albanian_web.pdf?la=en&vs=353

¹⁰¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

të motiveve të lidhura me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.

Parashikimet në Kodin Penal

- Neni 74/a parashikon se: “Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve, që mohojnë, minimizojnë, në mënyrë të ndjeshme, miratojnë ose justifikojnë akte, që përbëjnë gjenocid ose krim kundër njerëzimit, dënohet me burgim tre deri në gjashtë vjet.”.
- Neni 84/a parashikon se: “Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak përkatësie etnike, kombësie, race apo feje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”.
- Neni 119 parashikon se: “Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”.
- Neni 119/a parashikon se: “Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.”,
- Neni 119/b parashikon se: “Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.”.
- Neni 253 parashikon se: “Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të

drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.”.

- Neni 265 parashikon se: “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.”.
- Neni 266 parashikon se: “Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.”.

Gjuha e urrejtjes trajtohet, në mënyrë indirekte, në ligjin shqiptar kundër diskriminimit, konkretisht ligjin nr. 10221, të 4 shkurtit 2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.¹⁰² Mbështetur në këtë ligj, Komisioneri kundër diskriminimit i emëruar nga parlamenti është përgjegjës për vlerësimin e ankesave nga subjektet që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit, përfshirë nga administrata publike apo subjektet private; gjobat imponohen në rast të shkeljeve të konstatuara.¹⁰³ Ligji përfshin diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, diskriminimin për shkak të përkatësisë në një grup, etj. Ka një klauzolë të përgjithshme që ndalon diskriminimin dhe ligji parashikon masa specifike për diskriminimin në punë, në strehim, arsimim, në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, etj. Përveç kësaj, gjuha e urrejtjes nuk përmendet konkretisht në këtë ligj. Në përgjigje të kësaj, ndryshime të ligjit janë hartuar për të trajtuar më mirë këtë problem,¹⁰⁴ i cili konsiderohet i gjithë përhapur në shoqërinë shqiptare.¹⁰⁵ Në ligjin aktual, gjuha e urrejtjes bie në kategorinë e “shqetësimeve”. Kjo formë e diskriminimit ndodh në rastet e sjelljes së pakëndshme, në veçanti

¹⁰² Ligji nr. 10 221, datë 4 shkurt 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1308053956-Ligji-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi.pdf>

¹⁰³ Çdo person që shkel këtë ligj dënohet me gjobë si vijon: a) një person fizik, nga 10,000 në 60,000 lekë; b) një person jufidik, nga 60,000 në 600,000 lekë; c) një person fizik brenda një personi juridik që është përgjegjës për shkeljen, nga 30,000 në 80,000 lekë; d) një person që ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkeljen e këtij ligji, nga 30,000 në 80,000 lekë.

¹⁰⁴ Për më shumë shiko raportin e vitit 2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/05/Raporti-vjetor-2019-KMD.pdf>

¹⁰⁵ Për më shumë shiko raportet vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi: <https://www.kmd.al/raporte-vjetore/>

kur lidhet me ndonjë nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të ligjit,¹⁰⁶ duke pasur për qëllim apo duke shkaktuar dëmtimin e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, fyes apo poshtërues për atë person. Kjo zbatohet edhe në rastet e trajtimit jo të favorshëm që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë.

Një problematikë tjetër me interes për median është ndalimi i diskriminimit në reklama. Neni 8 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon posaçërisht publikimin e reklamave të ndryshme dhe njoftimeve nëse ato prezantojnë, haptazi ose në mënyrë të nënkuptuar, një qëllim për të diskriminuar për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Pavarësisht ankesave të mbledhura, deri tani nga Komisioneri në lidhje me forma të ndryshme të diskriminimit, përgjatë pesë viteve të fundit kanë qenë vetëm 14 ankesa mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes në media, ndërsa ankesa specifike në lidhje me rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në median *online* të regjistruara gjatë të njëjtës periudhe janë vetëm tre. Gjithashtu, për shkak të fokusit të ligjit mbi “përgjegjësinë individuale”, vendimet e Komisionerit mbi raste të caktuara të gjuhës së urrejtjes nuk i adresohen medias, por individit specifik që përdor gjuhën diskriminuese. Megjithëse ankesat lidhen kryesisht me gjuhën e përdorur në programet televizive, duhet të kihet parasysh se vendimet për të hequr materiale, apo për të fshirë deklaratat përkatëse prekin gjithashtu të gjitha postimet përkatëse në faqen e medias në internet, në rrjetet sociale apo platforma të ndryshme (më së shumti, YouTube).

Në mënyrë të ngjashme, Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Medias Audiovizive mund të marrë ankesa mbi përmbajtjen e programeve televizive, radiofonike apo të programeve të këtyre të fundit, të postuara *online*. Pavarësisht pak rasteve të raportuara në institucionet e përmendura më sipër, gjuha e urrejtjes mbetet e gjithë përhapur dhe e raportuar më pak në median shqiptare dhe në rrjetet sociale, ku një nga problemet kryesore është mungesa e moderimit të komenteve të lexuesve.

¹⁰⁶ Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Të drejtat e autorit në internet

E drejta e autorit është një formë e pronësisë intelektuale që i jepet me ligj autorëve të punëve krijuese për riprodhim ekskluziv të materialit që ata krijojnë. Të drejtat e pronësisë intelektuale të një autori njohën nga pika 2 e nenit 58 të Kushtetutës, nga legjislacioni vendës dhe nga Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, të cilën Shqipëria e ka nënshkrur më 1993.¹⁰⁷ Pavarësisht këtyre garancive të gjera, e drejta e autorit shpesh shkelet në Shqipëri, në veçanti në median *online*, ku riprodhimi i materialeve me të drejtë autori bëhet teknikisht pa shumë mundim.

Raporti “Harta e Medias *Online* në Shqipëri”,¹⁰⁸ publikuar nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) më 2018, zbuloi se, bazuar në përgjigjet e pronarëve dhe menaxherëve të medias *online*, dhunimet e të drejtës së autorit konsiderohen problemi më i madh me të cilin përballen mediat *online*, pasuar nga mungesa e informacionit cilësor dhe vështirësitë financiare.

Kodi Penal thotë se riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit, kur kanë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Sipas ligjit nr. 35/2016, datë 31 mars 2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar,¹⁰⁹ shkelja e të drejtës së autorit përbën përgjegjësi civile, administrative, kundërvajtje ose përgjegjësi penale.

Ky ligj dënon veprimet e dëmshme apo të paligjshme që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale, por nuk rregullon çështje të përmbajtjes *online* kur veprime të caktuara të kryera përmes internetit

¹⁰⁷ Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, <https://wipo.int/treaties/textdetails/12214>

¹⁰⁸ Instituti Shqiptar i Medias, 2018: “Peizazhi i Medias Online në Shqipëri,” http://www.osfa.al/sites/default/files/media_online_english.pdf

¹⁰⁹ Ligji nr. 35/2016, datë 31 mars, 2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Ligj_nr._35_dt._31.3.2016.pdf

cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale.¹¹⁰

Po kështu, nuk ka përcaktime specifike në ligjin për të drejtën e autorit për mbrojtjen e të drejtave të autorit *online*, por rregullat e përgjithshme janë të vlefshme edhe këtu. Ligji nr. 35/2016 shprehet se: *“Autorët duhet të përfitojnë nga mbrojtja e të drejtave të autorit për punët e tyre dhe sipas përkufizimeve të këtij ligji, qoftë edhe për vetë faktin e realizimit të një krijimi. Për rrjedhojë, ekzistenca dhe respektimi i të drejtës së autorit nuk përfshin nevojën për ndonjë regjistrim paraprak të punimit apo ndonjë formalitet tjetër.”.*

Për më shumë, e drejta e autorit mbrohet në përputhje me këto kritere dhe kushte:

- Punë të mbrojtura gjatë kohës kur autori është gjallë dhe deri 70 vjet pas vdekjes (neni 41.1).
- Të drejtat e pronësisë së një vepre me bashkëautorësi mbrohen deri në vdekjen e autorit të fundit dhe 70 vjet më pas (neni 41.3).
- Të drejtat e bashkëautorësisë në një punë të muzikës së shkruar mbrohen për 70 vjet pas vdekjes së autorit të fundit të mbijetuar, të autorit të tekstit apo të kompozitorit të veprës muzikore, kur kontributi ka qenë krijuar posaçërisht për përdorim në veprën muzikore (neni 41.4).
- Të drejtat pasurore të një vepre audiovizuale mbrohen deri në 70 vjet pas vdekjes së autorit të fundit të mbetur gjallë (Neni 41.5).
- Të drejtat pasurore të veprave anonime ose nën pseudonim mbrohen deri në 70 vjet. Afati llogaritet nga 1 janari i vitit pasardhës nga vënia e veprës në dispozicion të publikut (Neni 41.6).
- Të drejtat pasurore të përmbledhjeve mbrohen deri në 70 vjet nga vënia e veprës në mënyrë të ligjshme në dispozicion të publikut (Neni 41.7).
- Afatet e përcaktuara në këtë seksion fillojnë nga data 1 janar e vitit pasardhës të vdekjes së autorit ose, sipas rastit, të shfaqjes së parë të ligjshme në publik të veprës. (Neni 41.2).

¹¹⁰ Swiss Institute of Comparative Law, 2015: Blocking, Filtering, and Take-Down of Illegal Internet Content <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680651682>

Neni 8 i ligjit shprehet se artikujt letrarë apo krijimet e fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare dhe publicistike, si dhe fotot apo dokumentarët audiovizualë janë vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit, si *online* ashtu edhe *offline*. Pavarësisht mbrojtjes ligjore, që i jepet produkteve audio dhe vizuale nga e drejta e autorit, e drejta e autorit (neni 12.1) nuk mbron lajmet apo informacionin e shtypit, si *offline* ashtu edhe *online*, të cilat janë thjeshtë informuese. Përkufizimet në ligj nuk sqarojnë se cilat elementë të medias *online* mund të ndalohen për riprodhim pa autorizim dhe cilat mund të mos ndalohen, dhe as nuk ka specifikime për licencë për publikimin në median *online* në kuadrin legjislativ vendës.

Përveç kufizimeve të bazuara në legjislacionin vendor mbi mbrojtjen e të drejtës së autorit, ofruesit e përmbajtjes duhet të jenë të vetëdijshëm për politikat dhe rregullimet e përdorura nga media sociale dhe që përbëjnë shkelje të të drejtës së autorit apo përdorim të ndershëm në këto platforma. Në këtë kontekst, veprimet e një kompanie me bazë në Gjermani, Acromax Media, mbi shkeljet nga krijuesit e përmbajtjes në gjuhën shqipe, janë bërë emblematike për kërcënimet që rregullore të tilla mund të përbëjnë për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias. Acromax Media, Një kompani me bazë në Hamburg, e prezanton veten si kompani e menaxhimit të të drejtave digjitale, e cila përfshin mbrojtjen e përmbajtjes, marketingun dhe shpërndarjen. Ajo ka një listë me aktorët kryesorë të industrisë së dëfrimit dhe të medias në Shqipëri dhe mbron markat dhe produktet e tyre *online*. Mes klientëve të saj renditen televizionet kryesore si Top Channel, Klan, News 24, Vizion Plus, ABC News dhe platformat televizive me pagesë të tilla si Digitalb dhe Tring.

Gjithsesi, disa media *online* dhe aktivistë të opozitës kanë pretenduar se kompania është angazhuar gjithashtu për të hequr postime në internet, që janë kritike ndaj kryeministrit Edi Rama dhe kryetarit të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj – duke vepruar në këtë mënyrë si një mjet censure.¹¹¹ Aludohet se Acromax Media ka raportuar video kritike në median sociale të tilla si Facebook dhe YouTube, të cilat kanë përdorur përmbajtje pa lejen e ofruesve të saj, kur ato janë kritikë ndaj palëve në pushtet. Aktivistët dhe organizatat e të drejtave kanë pretenduar se Acromax Media raporton shkeljet e aluduara të të drejtave të autorit në platforma të tilla si Facebook dhe bën që

¹¹¹ Exit.al, 2019, Acromax Media — Albanian Government's Tool for Online Political Censorship, <https://exit.al/en/2019/08/19/acromax-media-albanian-governments-tool-for-online-political-censorship/>

materialet gazetareske të zhduken nga interneti.¹¹² Organizata Reporterët Pa Kufi ka konsideruar një praktikë të tillë si përpjekje për të shtypur gazetarinë e pavarur.

Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale përkufizohen si çdo informacion që lidhet me një person natyror të identifikuar apo të identifikueshëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në veçanti përmes referimit të një numri identifikimi apo të një apo më shumë faktorëve specifikë të identitetit të tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Ligji kryesor që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale është ligji nr. 9887, datë 10 mars 2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.¹¹³ Ligji përkufizon rregullat për mbrojtjen dhe kërkesat ligjore për përpunimin e të dhënave personale. Sipas këtij ligji, përpunimi ligjor i të dhënave personale duhet të respektojë dhe garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të drejtat e tyre për jetë private në veçanti. Ligji zbatohet për përpunimin e të dhënave personale – në tërësi apo pjesërisht nga mjete automatike – dhe në përpunimin e tyre me mjete të tjera përmes magazinimit në një sistem mbajtjeje apo që synohet të jenë pjesë e një sistemi mbajtjeje.

Ligji nr. 9887 është i zbatueshëm për çdo veprim të lidhur me përpunimin e të dhënave, përfshirë grumbullimin e tyre, magazinimin, publikimin dhe/ose transferimin e të dhënave personale te secili nga këto subjekte:

- kontrolluesit e të dhënave;
- misionet diplomatike ose zyrat konsullore të shtetit shqiptar;
- kontrollues, të cilët nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, por që e ushtrojnë

¹¹² Netzpolitik.org, 2020, A German company is responsible for the deletion of videos critical of the Albanian government, <https://netzpolitik.org/2020/a-german-company-is-responsible-for-the-deletion-of-videos-critical-of-the-albanian-government/>

¹¹³ Ligji nr. 9887, datë 10 mars 2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale,” https://www.idp.al/wp-content/uploads/2019/10/LDP_english_version_amended_2014.pdf

veprimtarinë nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë; dhe

- përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, për kryerjen e një veprë penale kundër rendit publik dhe të veprave të tjera në fushën e të drejtës penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Ai zbatohet gjithashtu për përpunimet automatike dhe jo-automatike. Bazuar në specifikimet e ligjit, AKEP, si çdo autoritet tjetër publik në Shqipëri, është subjekt i detyrimit për të mbrojtur të dhënat personale gjatë grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe/ose transferimit të tyre.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si një autoritet i pavarur për mbikëqyrjen dhe monitorimin si të mbrojtjes së të dhënave personale ashtu edhe për të drejtën e informimit, duke respektuar dhe garantuar këto të drejta dhe liri themelore në përputhje me ligjin.

Sipas ligjit nr. 9887, çdo person, të dhënat e të cilit janë përdorur dhe/ose publikuar mund të ushtrojnë të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin apo fshirjen. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të kërkojë korrigjimin apo fshirjen, pa pasur nevojë të paguajë, kurdo që informohet se të dhënat e tij janë mbledhur në mënyrë të parregullt, nuk janë të vërteta apo janë të paplota ose nëse të ardhurat e tyre janë mbledhur dhe përpunuar në kundërshti me kriteret ligjore. Brenda 30 ditëve nga marrja e të dhënave subjekt i kërkesës, kontrolluesi duhet të njoftojë subjektin e të dhënave për procesimin e ligjshëm të tyre, si dhe të njoftojë nëse të dhënat janë bllokuar, korrigjuar apo fshirë. Në raste të tilla, organizatat e medias konsiderohen si subjekte që funksionojnë si kontrollues të dhënash.

Kur kontrolluesi nuk nis bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave sipas kërkesës, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te Komisioneri. Pas kësaj ankese, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë duke kërkuar kompensim.

Ligji ka parashikuar një regjim specifik për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me lirinë e shprehjes. Një udhëzim i posaçëm është publikuar mbi kushtet që duhet të plotësohen kur përpunohen të dhëna për qëllime gazetareske, letrare apo artistike, të cilat përjashtohen nga detyrime të caktuara ligjore, të cilat lejohet deri në atë përmasë që pajtojnë të drejtën për të mbrojtur të dhënat personale me rregullat që qeverisin lirinë e shprehjes.

Sipas Udhëzimit nr. 9, datë 15 shtator 2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar,¹¹⁴ çdokush që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetareske, letrare apo artistike, duket të marrë në konsideratë të drejtën e individit, që i përkasin këto të dhëna për të drejtat e tij personale. Bazuar në këtë udhëzim, ruajtja e konfidencialitetit (fshehtësi, afërsi, familjaritet, besim) është e drejtë themelore e individit dhe nuk duhet të dalë si një pengesë e dorës së dytë, ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së gazetarit apo çdo subjekti tjetër. Media e shkruar, vizive dhe audiovizive duhet të kujdeset që të mos publikojë informacione të pasakta, mashtruese ose të shtrembëruar, duke përfshirë edhe fotot. Në momentin kur vihet re një pasaktësi e konsiderueshme, deklarata mashtruese ose shtrembërim i njohur duhet të korrigjohet, menjëherë dhe me rëndësinë e duhur. Në median e shkruar, duhet të bëhet i qartë dallimi midis komentit, hamendësimit dhe faktit.

Gazetari duhet të garantojë të drejtën për informim mbi lajmin me interes publik, duke ruajtur thelbin e informacionit, por duke shmangur kur është e mundur referencat ndaj të dhënave personale që tregojnë racën, etninë, bindjet fetare, filozofike apo të ngjashme me to, bindjet politike, anëtarësitë partiake, anëtarësinë në shoqata filozofike apo politike si dhe të dhëna që mund të zbulojnë gjendjen e tyre shëndetësore dhe orientimin seksual.

Gazetarët duhet të respektojnë të drejtën e personit për mosdiskriminim bazuar në racë, besim, bindje politike, gjini, orientim seksual dhe tipare personale, fizike apo mendore. Përveç esencës së informacionit, gazetari nuk duhet të japë lajme apo të publikojë foto të personave të përfshirë në ngjarje, të tilla që dëmtojnë dinjitetin e personit dhe nuk duhet t’i referohet detajeve të dhunës,

¹¹⁴ Udhëzimi nr. 9, 15 shtator, 2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar, https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/instruction_no_09.pdf. Ky seksion është marrë nga udhëzimi me ndryshime minimale për qëllim qartësimi.

përveç rastit kur ata e konsiderojnë këtë si lajm apo si një interes publik. Përveçse kur bëhet fjalë për informacion që është i rëndësishëm për interesin publik, për drejtësinë apo për çështje policore, gazetari nuk duhet të marrë apo bëjë foto të njerëzve që janë duke u arrestuar pa lejen e tyre. Personat nuk duhet të filmohen kur janë me pranga.

Gazetat dhe media vizuale apo audiovizuale duhet të marrin parasysh këto parime të privatësisë:

- Çdo person ka të drejtë t'i respektohet jeta e tyre private apo familjare, shtëpia dhe shëndeti si dhe korrespondenca, përfshirë komunikimet digjitale.
- Gazetarët nuk duhet të ndërhyjnë në jetën private të të tjerëve pa lejen e tyre.
- Është e papranueshme të publikosh foto të individëve në vende private pa lejen e tyre. Vendet publike konsiderohen publike ose private në varësi të bindjes së arsyeshme për praninë e intimitetit në to.

Të dhënat sensitive mund të përpunohen nga gazetarët vetëm pasi ata të kenë marrë leje nga personi i interesuar, ndërsa një leje e tillë mund të revokohet në çdo kohë. Leja nuk është e nevojshme kur gazetarët janë duke iu nënshtruar të drejtave dhe kufizimeve të lirisë së shtypit të dhëna nga Kushtetuta dhe dokumente të tjera, në mënyrë të posaçme në lidhje me ngjarjet që kanë interes publik.

Interesi publik do të konsiderohet brenda këtyre kufizimeve:

- interesi i sigurisë kombëtare;
- integriteti territorial ose siguria publike;
- parandalimi i trazirave apo krimit;
- parandalimet publike nga të qenit i mashtroar nga një veprim apo deklaratë e një individi;
- mbrojtja e shëndetit ose e moralit;
- mbrojtja e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve;
- parandalimi i zbulimit të informacioneve konfidenciale, ose për të garantuar paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, etj.

Udhëzimi kërkon gjithashtu që në kapacitet të kontrolluesit të të dhënave, gazetarët të jenë subjekt i detyrimeve ligjore për të bashkëpunuar me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke siguruar në këtë mënyrë që të japë të gjithë informacionin që zyra e Komisionerit mund të ketë nevojë për të kryer detyrat e veta, siç përcaktohen në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Të gjithë kontrolluesit publikë apo privatë në median e shtypur, vizuale apo audiovizuale në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruar të respektojnë këtë udhëzim. Shkelja e rregullave të dhëna në këtë udhëzim konsiderohet në shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë në 500 mijë lekë (EUR 4,050.12).

Dy lloje udhëzimesh të posaçme për gazetarët në mbrojtje të të dhënave sensitive janë renditur më poshtë.

Vëmendje e veçantë: Mbrojtja e të miturve

Vëmendje e veçantë brenda Kushtetutës, si pjesë e ligjit nr. 18/2017 “Për mbrojtjen e fëmijëve”, dhe në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve¹¹⁵ – të cilën Shqipëria e ratifikoi më 1992 – i jepet mbrojtjes së fëmijëve, për shkak se këto janë mes grupeve më të ndjeshme dhe në nevojë në lidhje me rreziqet e dhunimit të të drejtave të tyre themelore, në veçanti, të drejtës së tyre për privatësi. Të miturit nën 16 vjeç nuk mund të intervistohen apo fotografohen për çështje që përfshijnë mirëqenien (progresin) e tij apo të një fëmije tjetër, përveç rasteve kur prindi përgjegjës jep leje. Për më shumë, studentët nën moshën 16 vjeç nuk duhet të fotografohen apo intervistohen në shkollë pa lejen e autoriteteve të shkollës.

Gazetarët nuk duhet të publikojnë emrat e të miturve të përfshirë në lajme, apo të japin detaje që mund të sjellin identifikimin e tyre. Mbrojtja e identitetit të një fëmije duhet të marrë parasysh cilësinë e lajmit dhe komponentëve të tij. Përhapja e detajeve, me çdo mjet, i

¹¹⁵ UN OHCHR: <https://ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

lajmeve apo fotove që identifikojnë një fëmijë të përfshirë në krim, është i ndaluar. Gazetarët nuk duhet të identifikojnë të miturit nën 16 vjeç, që janë viktime apo dëshmitarë të krimeve seksuale. Në çdo raport mediatik në një rast të tillë, përfshirë një krim seksual kundër një të mituri, ia/ajo nuk duhet të identifikohet dhe vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mos identifikimit të një fëmije në mënyrë indirekte, përmes publikimit të të dhënave të lidhjes së të akuzuarit me fëmijën.

E drejta e një të mituri për jetë private, në veçanti në rastet e abuzimeve, gjithmonë merr përparësi në krahasim me të drejtën për lirinë e shprehjes, dhe kjo është gjithashtu e vlefshme në rastet kur identiteti i tyre bëhet i ditur përmes burimeve zyrtare apo anëtarëve të familjes. Përveç kësaj, shtypi nuk duhet të identifikojë viktimat e dhunës seksuale, apo të publikojë materiale, që mund të kontribuojnë në një identifikim të tillë.

Lajmi se një fëmijë është adoptuar nuk mund të publikohet pa lejen e prindërve birësues. Në të njëjtën kohë, gazetarët duhet të mos publikojnë të dhëna që dhunojnë privatësinë e personave të birësuar apo atyre birësuar.

Anonimiteti i të miturit duhet të ruhet në çdo proces ligjor, veçanërisht në proceset ku një i mitur është i përfshirë në një rast zgjidhje martese apo në raste të tjera të caktuara, që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre shoqëror, mendor dhe psikologjik.

Gazetarët duhet t'i japin prioritet interesit më të lartët të miturit, të marrin parasysh natyrën e marrëdhënies mes prindërit dhe fëmijës dhe të shohin nëse prindërit janë apo jo në pozicion për të përfaqësuar pozitivisht interesat e fëmijës. Informacioni i marrë nga prindërit e një fëmije mundet që jo gjithmonë të raportohet nga gazetari, për shkak se ata janë gjithmonë përgjegjës për të vlerësuar nëse publikimi është në interesin më të mirë të fëmijës, duke nënkuptuar me këtë mbrojtjen zhvillimit personal, shoqëror, mendor dhe psikologjik të fëmijës.

Emri i një të mituri me sëmundje të rënda nuk duhet të përdoret për qëllime propagandistike apo ndonjë arsye tjetër që është në konflikt me të drejtat e tyre dhe që nuk i jep prioritet

dinjitetit të tyre.

Të miturit në kushte të rënda krize nuk duhet të intervistohen (për shembull, kur ata janë arratisur nga shtëpia, ose kur janë përdorur nga krimi i organizuar, ose për prostitucion, etj.). Nëse një intervistë është e nevojshme për interesin publik, anonimiteti i të miturit duhet të ruhet në maksimum. Pjesëmarrja e të miturve në programe në të cilat ngarkesa emocionale e fëmijës po diskutohet, nuk lejohet. Për më shumë, gazetarët nuk duhet të përdorin famën apo pozitën e një prindi apo përgjegjësi, si justifikim për të publikuar detajet e jetës private të një të mituri.

Vëmendja e veçantë: Raportimi nga kronika e zezë

Rregulla të posaçme janë hartuar për mbrojtjen e të dhënave private në procese penale. Përgjatë raportimit mbi një krim, të afërmit apo shokët e personit apo personave të dënuar apo atyre që janë akuzuar për një krim, nuk duhet të identifikohen pa lejen e tyre. Në të njëjtën kohë, gazetarët janë përgjegjës për tu siguruar që informacioni i publikuar është i plotë, i saktë dhe i përditësuar. Për më shumë, garancitë themelore të të akuzuarit duhet të respektohen në çdo rast dhe gjithashtu duhet të respektohet prezumimi i pafajësisë.

Mund të ketë raste kur është e vështirë të vëresh nëse akuzat e bëra nga një palë e tretë janë të vërteta apo jo, por ato duhet të raportohen për shkak të interesit publik. Nëse redaktorët dëshirojnë të publikojnë materiale në këto rrethana, ata duhet ta bëjnë pa mbrojtur të akuzuarin. Redaktorët duhet të kenë parasysh se që të gjithë – përfshirë ata që akuzohen apo janë dënuar në lidhje me një krim – gëzojnë të drejtën që t'i respektohet privatësia, si dhe shtëpia, prona, shëndeti dhe korrespondenca.

Respekti për parimin e prezumimit të pafajësisë është pjesë përbërëse e ligjit, në mënyrë që të sigurojë proces të drejtë pa shkelje ligjore. Opinionet dhe informacioni në lidhje me procedimet penale, që janë duke u kryer duhet të komunikohen nga shtypi vetëm nëse ato

nuk prekin prezumimin e pafajësisë për një të dyshuar apo person të akuzuar për një krim të caktuar.

Për dhënien e informacioneve që kanë lidhje me persona të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar, ose me subjekte të tjerë të lidhur në njëfarë mënyrë me këtë proces, duhet të respektohet e drejta e privatësisë së këtyre personave, sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në mënyrë të veçantë kjo ruajtje duhet t'i garantohet personave të mitur, atyre më të dobët qofshin këta viktime, dëshmitarë si dhe familjarët e personave të dyshuar, akuzuar apo të dënuar. Në çdo rast duhen pasur parasysh veçanërisht pasojat e dëmshme që mund t'i vijnë personave në fjalë si rrjedhojë e daljes së informacioneve që mund të çojnë në zbulimin e identitetit të tyre.

Nuk duhet zbuluar identiteti i dëshmitarëve, me përjashtim të rastit kur këta persona kanë dhënë më parë miratimin e tyre, kur identifikimi i dëshmitarëve është në interesin e publikut, ose dëshmia ka qenë bërë publike më parë. Në mënyrë të veçantë nuk duhet të zbulohet identiteti i dëshmitarit kur mund të vijë si pasojë vënia në rrezik e jetës ose e sigurisë së tij. Duhet respektuar masat e parashikuara nga programet e mbrojtjes për dëshmitarët, sidomos ne procedimet penale që kanë lidhje me krimin e organizuar ose me vepra penale me karakter familjar. Gazetarët lejohen të kenë kontakte me personat që janë duke kryer dënimin në burg, në atë masë që të mos paragjykojë korrektesën e funksionimit të drejtësisë, të drejtat e të dënuarve dhe të personelit të burgut ose sigurinë e institutit të vuajtjes së dënimit.

Ndalohet përhapja e emrave të personave të hetuar apo nën gjykim, me qëllim mbrojtjen e privatësisë dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me persona të tretë të përfshirë në hetime.

Përhapja e emrave të personave të dënuar në krahasim me rastet që kanë të bëjnë me të hetuarit dhe të akuzuarit, mund të kryhet më lirisht duke qenë se është dhënë një gjykim i parë nga ana e gjykatës. Gazetarët duhet të vlerësojnë rast pas rasti publikimin e të

dhënave identifikuese të të dënuarit, pasi duhet të merren në konsideratë, ndër të tjera, cilësitë e veçanta të subjekteve të përfshirë, për shembull, persona me aftësi të kufizuar apo shqetësime psikike, llojin e krimit të verifikuar, etj.

Gazetarët, me përjashtim kur ekzistojnë pengesa specifike, mund të bëjnë publike të dhëna të familjarëve dhe të njohurve të personave të dyshuar, akuzuar apo të dënuar, që rezultojnë drejtpërdrejtë të përfshirë në ngjarje. Nuk lejohet bërja publike e të dhënave të personave të mësipërm vetëm për faktin se kanë marrëdhënie sentimentale dhe bashkëjetese me të, apo për shkak të rrethanave të faktit (p.sh. duhet hequr identiteti i atij që rezulton të jetë pronari i banesës ku është kryer një krim).

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR)

Nuk ka pasur legjislacion të posaçëm të miratuar për të zbatuar Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR)¹¹⁶ në Shqipëri. Ndryshimet ligjore për të sjellë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me GDPR-në parashikohen në strategjinë 2018-2020 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, por nuk janë miratuar ende.¹¹⁷

Një tipar domethënës i GDPR-së është se ajo zbatohet jashtë kufijve të Bashkimit Evropian (përmes parimit të ekstra-territorialitetit). Kjo për shkak se të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave jashtë BE-së, përfshirë ata në Shqipëri, duhet të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga mbrojtja e të dhënave nga BE kur përpunojnë të dhëna nga individë brenda BE-së, të tilla si në rastet kur firma joevropiane ofrojnë mallra dhe shërbime për shtetasit e BE-së. GDPR është gjithashtu e zbatueshme kur bizneset apo llojet e tjera të organizatave janë duke monitoruar sjelljen e individëve brenda BE-së.

¹¹⁶ Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR): <https://gdpr-info.eu/>. Për më shumë informacion, shiko: https://ec.europa.eu/info/law/law-topic/data-protection_en

¹¹⁷ Shiko dokumentin e strategjisë 2018-2020: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/Strategjia_per_te_Drejte_n_e_Informimit_dhe_Mbrojtjen_e_te_Dhenave_Personale.pdf

Nuk ka aktualisht, rregulla specifike në lidhje me të drejtën “për t’u harruar” – praktikën e heqjes së informacionit personal apo privat nga faqet e internetit dhe/ose indekset e motorëve të kërkimit – por ndyshime të planifikuara në ligjin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave synojnë ta sjellin atë në përputhje me GDPR-në dhe pritet të rregullojnë edhe të drejtën “për t’u harruar”.¹¹⁸ Mbikëqyrja e procesit të ndryshimeve ligjore ka rëndësi kritike, në mënyrë që e drejta “për t’u harruar” të miratohet duke marrë parasysh parimet e lirisë së medias.¹¹⁹

Kodi i etikës për gazetarët

Kodi i etikës për gazetarët në Shqipëri është një instrument vetërregullues i hartuar për të fuqizuar cilësinë dhe profesionalizmin e gazetarisë në Shqipëri dhe për të krijuar ndjesinë e llogaridhënies në gazetari dhe institucionet mediatike para lexuesve të tyre, shikuesve dhe publikut të gjerë. Kodi i parë i etikës për median shqiptare u hartua më 1999, por shumë pak organizata mediatike e miratuan atë si dokument rregullues të brendshëm.

Kodi më i fundit i etikës është hartuar më 2018 nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen e Projektit për Riforcimin e Ekspertizës Juridike në Lirinë e Shprehjes dhe të Medias në Evropën Juglindore (JUFREX) – një iniciativë e përbashkët e udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.¹²⁰ Preambula e Kodit shprehet se:

“Kodi i Etikës është një instrument vetërregullues që synon të forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri.

Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë, të njohura dhe të pranura gjerësisht nga mediat dhe organizatat e gazetarëve në vendet demokratike. Ato përbëjnë gurin e themelit të pluralizmit demokratik dhe po ashtu respektojnë frymën

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ Michael J. Oghia, 2018, Information Not Found: The “Right to Be Forgotten” as an Emerging Threat to Media Freedom in the Digital Age, <https://cima.ned.org/publication/right-to-be-forgotten-threat-press-freedom-digital-age/>

¹²⁰ Teksti i plotë i Kodit të Etikës mund të gjendet këtu: <https://kshm.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikes-final-English-4.pdf>

e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Rregullat dhe kodi i sjelljes i përcaktuar në Kodin e Etikës janë të zbatueshme për të gjithë personat dhe organizatat e angazhuara në grumbullimin, redaktimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit gazetaresk. Kjo përfshin si median e shtypur ashtu edhe atë elektronike si dhe të gjitha platformat gazetareske, *offline* dhe *online*, përfshirë gazetarinë e shpërndarë përmes mediave sociale dhe portaleve në internet. Kodi mbulon shumë nga fushat e tjera, përfshirë:

- Saktësinë dhe paanësinë e informacionit;
- Gjuhën shqipe;
- Konfliktin e interesit;
- Dallimi i faktit nga opinioni;
- Pavarësinë editoriale;
- Gjuhën e urrejtjes;
- Nxjitjen e krimit apo dhunës;
- Të drejtat e pronësisë intelektuale;
- Ndërhyrjet në jetën private;
- Përgjegjësitë pas publikimit;
- Marrëveshjet para publikimit;
- Mbrojtjen e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Interesin publik;
- Korrigjimin dhe përgjigjen;
- Marrëdhëniet mes gazetarëve;
- Marrëdhëniet me burimet;
- Raportimin e aksidenteve dhe katastrofave; dhe
- Raportimin e proceseve gjyqësore dhe prezumimin e pafajësisë.

ISHM ka publikuar gjithashtu një set Udhërrëfyesish Etikë për Gazetarinë në Internet me

mbështetjen e JUFREX.¹²¹ Mekanizmi vetërregullues përcakton një numër parimesh të lidhura me specifikat e publikimeve në internet që duhet të respektohen nga gazetarët shqiptarë dhe media (të renditura në kuadratin më poshtë).

Sipas këtyre udhërrëfyeseve, gazetaria në internet duhet të respektojë kodin e etikës profesionale dhe vlerat bazë të gazetarisë, pavarësisht forumit apo formatit që ajo përdor. Në veçanti, informacioni i publikuar nga media në internet duhet të jetë:

- I saktë dhe i mbështetur në fakte;
- I verifikuar dhe i publikuar pa sensacionalizëm;
- Publikuar pa qëllim për të dëmtuar të tjerët;
- I paanshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjitha këndvështrimet; dhe
- Transparent mbi origjinën e përmbajtjes dhe metodave të gazetarisë të përdorura.

Parimet etike për publikimet *online*

- Respekti i dinjitetit, reputacionit dhe privatësisë së individëve.
- Ndalimi i publikimit të materialeve që nxisin urrejtje apo dhunë, apo shkaktojnë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësive fizike apo mendore, orientimit seksual, bindjeve politike apo fetare, statusit etnik apo shoqëror.
- Parandalimin e bullizmit në internet dhe të publikimit të materialeve dashakeqëse me synimin e dëmtimit të të tjerëve, në veçanti në forumet e dedikuara për të rinjtë dhe të miturit.
- Dallimin mes përmbajtjes editoriale dhe asaj të gjeneruar nga përdoruesit.

¹²¹ Udhërrëfyesi gjendet këtu: <https://kshm.al/wp-content/uploads/2018/04/ETHICAL-GUIDELINES-FOR-ONLINE-JOURNALISM-7.pdf>

- Të kujdeset që lidhjet e vendosura në faqe të mos i drejtojnë përdoruesit në faqe të tjera që mbartin informacion qëllimisht të dëmshëm, të falsifikuar apo që nuk respektojnë Kodin e Etikës së Gazetarisë.
- Të monitorojë përmbajtjen e gjeneruar nga lexuesit, përfshirë në faqet e internetit dhe në mediat sociale, në mënyrë që të marrë masa për të parandaluar apo ndaluar publikimin e përmbajtjes së dëmshme, përmbajtjes që dhunon dinjitetin e njeriut, privatësinë, apo gjuhën e urrejtjes.
- Të publikojë rregullat dhe politikat për menaxhimin e përmbajtjes së palëve të treta që përdoruesit duhet të ndjekin për të shtuar komente apo përmbajtje të tjera në faqet e tyre dhe të bëjë të disponueshëm një mekanizëm raportimi.
- Të heqë sa më shpejt që të jetë e mundur përmbajtjen e papranueshme dhe komentet që përbëjnë gjuhë urrejtjeje, rrezikojnë sigurinë apo integritetin fizik të individëve, ose që mund të shkaktojnë dhunime të tjera serioze të të drejtave të njeriut.
- Të ketë politika dhe mekanizma të posaçme për identifikimin dhe heqjen e shpejtë të përmbajtjes seksuale apo imazheve intime jo konsensuale (të tilla si foto, video etj.) për shkak të ndikimit veçanërisht të rëndë që këto kanë në privatësinë dhe dinjitetin e personave të prekur.
- Të miratojnë mekanizma efikas për rishikimin e ankesave të publikut apo raportimeve mbi materiale që mund të jenë të dëmshme apo në dhunim të politikave të faqeve të internetit.
- Ngarkon me detyrën për t'u kujdesur kur përdor përmbajtje të palëve të treta të marra nga media sociale ose të ofruara nga publiku i gjerë.
- Të tregojë kujdes për t'u siguruar që përmbajtja e gjeneruar nga përdoruesit të mos bëhet një mjet për promovimin apo justifikimin e paligjshmërisë në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti.
- Të mbajë arkivë *online* për përmbajtjen e tyre të publikuar.
- Të respektojë rregullat për të drejtën e autorit të caktuara në Kodin e Etikës.

Pavarësisht progresit të arritur, ky kod është instrument vullnetar. Për rrjedhojë, nuk është e qartë se sa prej mediave janë të gatshme ta respektojnë atë dhe rekomandimet e Këshillit Shqiptar të Medias. Gjithashtu nuk ka ndonjë mekanizëm konkret zbatimi apo të trajtimit të ankesave.¹²²

VIII. HEQJA E PËRMBAJTJES SË PALIGJSHME



Përveç mënyrës se si të dhënat menaxhohen nga platformat digjitale, ndërmjetësit dhe palët e treta, siç u përshkrua më sipër, moderimi i përmbajtjes dhe politikat e heqjes së materialeve janë disa nga temat më gjerësisht të debatuar – dhe përçarëse – në qarqet politikëbërëse globale. Shpesh kushtet e përdorimit në një platformë në internet janë të gjata, komplekse dhe qëllimisht të vështira për t'u kuptuar, gjë që sjell konfuzion mbi atë që konsiderohet përmbajtje e përshtatshme apo e papërshtatshme. E kombinuar kjo me politika të mjegullta apo të papërshtatshme që detajojnë se kur një përmbajtje duhet apo nuk duhet të hiqet, kjo sjell shumë probleme me heqjen e përmbajtjes së papërshtatshme, të tilla si zbatim jo konsistent i rregullave mbi heqjen e përmbajtjeve që kanë qëllime historike, edukuese, dhe/ose interes publik.

Qeveritë i janë përgjigjur kësaj sfide në mënyra të ndryshme, si ajo që i kërkon një apo më shumë platformave digjitale të moderojnë përmbajtjen e tyre (siç është rasti i Gjermanisë¹²³) apo përmes krijimit të standardeve, parimeve dhe identifikimit të praktikave më të mira mbi mënyrën se si mund të trajtohet dizinformimi dhe keqinformimi (siç është rasti i Kodit të Praktikave mbi Dizinformimin të Bashkimit Evropian¹²⁴). Platformat e medias sociale, të tilla si Facebook, i janë përgjigjur duke u mbështetur më shumë në moderimin e përmbajtjes dhe inteligjencës artificiale (d.m.th., makinën që mëson), për të identifikuar automatikisht përmbajtjen e dëmshme, apo përmes masave të

¹²² Për më shumë informacion shiko faqen e internetit të Këshillit Shqiptar të Medias: www.kshm.al

¹²³ Ligji është i disponueshëm në: https://bmjv.de/SharedDocs/Gesetzgebungsverfahren/Dokumente/RegE_NetzDG.pdf?__blob=publicationFile&v=2, ndërsa analiza mund të aksesohet në: <https://nytimes.com/2018/05/19/technology/facebook-deletion-center-germany.html>

¹²⁴ <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/code-practice-disinformation>. The New York Times ofron gjithashtu shembuj se si zjidhje të shumta nevojiten për të trajtuar keqinformimin: <https://youtu.be/yA-FCxFAQNHg>

tjera teknologjike – gjë që ka pasur rezultate të përziera.¹²⁵

Nuk ka një ilaç të vetëm të vlefshëm për moderimin e përmbajtjes dhe fshirjen e asaj të dëmshme; përmbajtja e dëmshme ndikon negativisht te moderatorët njerëzorë, ndërsa teknologjia në mënyrë tipike nuk është në gjendje të dallojë nuancat. Përmbajtja e dhunshme apo ekstremiste, pornografia me fëmijë, përmbajtja e lidhur me vetëvrasjet dhe një numër formash të tjera përmbajtjeje të dëmshme duhet të trajtohen siç duhet pa nxitur censurë apo pa minuar enkriptimin në dy krahët,¹²⁶ apo pa cenuar lirinë e shtypit, ndërkohë që duhet të trajtohen problemet më të vështira me moderimin e përmbajtjes, të tilla si nuditeti. Në vend të kësaj, një përzierje zgjidhjesh është e nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar në:

- Rregullim gjithëpërfshirës dhe i mbështetur mbi prova, në veçanti me synimin e reformimit të ligjeve dhe rregulloreve arkaike dhe/ose hartimit të ligjeve apo rregulloreve të reja për të reflektuar përdorimin aktual të zhvillimit teknologjik;
- Mbikëqyrje më të madhe, transparencë dhe llogaridhënie për platformat *online*, mbi algoritmet që përdoren për renditjen e materialeve dhe për moderimin e tyre dhe mbi ofruesit e shërbimeve digjitale;
- Rritja e shkallës së edukimit mbi median digjitale dhe edukim mbi të menduarit kritik;
- Kontroll i shëndoshë dhe i saktë i fakteve; dhe
- Procese gjithëpërfshirëse, bashkëpunuese dhe me shumë aktorë për krijimin e setit të praktikave më të mira mbi moderimin e komenteve dhe vetë-rregullim efikas dhe llogaridhënës.

Në mënyrë të pashmangshme po ngrihen pyetje se si duhet të rregullohet përmbajtja në internet, veçanërisht përmbajtja shërbimeve mediatike përmes internetit *over-the-top* (OTT), të tilla si

¹²⁵ Article 19, 2018, Regulating social media content: Why AI alone cannot solve the problem, <https://article19.org/resources/regulating-social-media-content-why-ai-alone-cannot-solve-the-problem/> and Center for Democracy & Technology, 2017, Mixed Messages?

The Limits of Automated Social Media Content Analysis, <https://cdt.org/wp-content/uploads/2017/11/2017-11-13-Mixed-Messages-Paper.pdf>

¹²⁶ Himanshu Gupta and Harsh Taneja, 2018, WhatsApp has a fake news problem—that can be fixed without breaking encryption, https://cjr.org/tow_center/whatsapp-doesnt-have-to-break-encryption-to-beat-fake-news.php

Airbnb, Netflix, Skype, Viber dhe WhatsApp, të cilat janë të rëndësishme për çdo diskutim të këtyre çështjeve brenda politikës së medias dhe asaj digjitale në Shqipëri. Organizata, forume dhe iniciativa, të tilla si Forumi Ekonomik Botëror (WEF),¹²⁷ Access Now,¹²⁸ RSF përmes Iniciativës së Trustit për Gazetarinë (JTI),¹²⁹ Qendra për Demokraci dhe Teknologji (CDT),¹³⁰ iniciativa Evropiane për të Drejtat Digjitale (EDRi),¹³¹ ARTICLE 19,¹³² Global Partners Digital (GPD),¹³³ Shoqata për Komunikime Progresive (APC),¹³⁴ Iniciativa e Rrjetit Global (GNI),¹³⁵ Forumi Global për Zhvillimin e Medias (GFMD),¹³⁶ Forumi i OKB-së për Qeverisjen e Internetit (IGF),¹³⁷ dhe shumë të tjerë – përfshirë Reporterin Special të OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe të shprehjes¹³⁸ – vijnë të kërkojnë për mënyrat më të mira për harmonizimin e ligjeve, politikave dhe rregulloreve me lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit dhe liritë dhe të drejtat e tjera themelore. Secila ofron raste studimore të rëndësishme dhe në respekt të të drejtave si dhe rekomandime të nxjerra nga praktikat më të mira ndërkombëtare, të tilla që mund të ofrojnë udhërrëfim për këtë proces në Shqipëri.

Moderimi dhe fshirja e përmbajtjes

Nuk ka ndonjë ligj specifik që rregullon procesin e filtrimit dhe bllokimit të përmbajtjes e paligjshme në internet. Gjithsesi, parashikimet e ligjeve të ndryshme rregullojnë përmbajtjen e paligjshme

¹²⁷ <https://weforum.org/agenda/2018/02/hoë-should-we-regulate-the-flow-of-online-content-here-are-three-crucial-facts-in-the-debate-over-digital-media/>

¹²⁸ <https://accessnow.org/watch-bad-regulation-ott-services-can-risk-rights/>

¹²⁹ <https://jti-rsf.org/en/>

¹³⁰ <https://cdt.org/area-of-focus/free-expression/>

¹³¹ <https://edri.org/theme/freedom-of-expression/>

¹³² <https://article19.org/issue/media-freedom/> dhe <https://article19.org/issue/censorship/>

¹³³ <https://gp-digital.org/wp-content/uploads/2018/05/A-rights-respecting-model-of-online-content-regulation-by-platforms.pdf>

¹³⁴ <https://ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/ContentRegulation/APC.pdf>

¹³⁵ <https://globalnetworkinitiative.org/>. Në veçanti shiko, *GNI Principles on Freedom of expression and Privacy*: <https://globalnetworkinitiative.org/gni-principles/>

¹³⁶ <https://gfmd.info/internet-governance/>. Shiko gjithashtu: <https://bit.ly/IssuePaperV4>

¹³⁷ Për shembull, shiko punën e *Dynamic Coalition on Platform Responsibility* (<https://bit.ly/IGF-DCPR>) dhe *Dynamic Coalition on the Sustainability of Journalism and News Media* (<https://bit.ly/IGF-DCSustainability>).

¹³⁸ <https://freedex.org/a-human-rights-approach-to-platform-content-regulation/>

në internet. Ligji nr. 9918, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ngarkon AKEP për të zbatuar kërkesat e ligjit. Një nga veprimet zbatuese është lëshimi i një autorizimi të përgjithshëm për ISP-të që duan të ofrojnë shërbime të rrjetit dhe të komunikimeve elektronike. Ky autorizim është subjekt i një numri kushtesh, përfshirë kufizimin në lidhje me përmbajtjen e paligjshme apo të dëmshme (Neni 15, paragrafi 1/e).

Deri tani, AKEP mund të dërgojë një kërkesë, të një apo më shumë ISP, bazuar në vendimet e autoriteteve kompetente, si dhe të monitorojë zbatimin nga ISP-të të urdhrave për bllokimin apo heqjen e përmbajtjes së paligjshme. Me krijimin e databazës *online* nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (ACESK) më 2020, ISP-të do të informohen automatikisht për të gjitha vendimet që lidhen me heqjen e përmbajtjes së paligjshme të marra nga autoritetet kompetente. AKEP do të monitorojë zbatimin e vendimeve të tilla.

Nuk ka një listë zyrtare apo të publikuar mbi atë se çfarë konsiderohet përmbajtje e paligjshme apo e dëmshme e autoritetit kompetent, që mund t'i kërkojë ISP-ve të heqin përmbajtjen e paligjshme. Për këtë arsye, institucionet kyçe të mandatuara nga ligji për të urdhëruar heqjen e përmbajtjes së paligjshme janë të renditura më poshtë, gjë që është krijuar bazuar në rastet e shqyrtuara nga AKEP.

Drejtësia dhe agjencitë ligjzbatuese mund të kërkojnë heqjen e përmbajtjes së paligjshme bazuar në nene të caktuara të Kodit Penal. Këto përfshijnë:

- Neni 74/a – Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve, që mohojnë, minimizojnë, në mënyrë të ndjeshme, miratojnë ose justifikojnë akte, që përbëjnë gjenocid ose krim kundër njerëzimit;
- Neni 84/a – Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak përkatësie etnike, kombësie, race apo feje;
- Neni 119/a – Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike;
- Neni 119/b – Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një

personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë;

- Neni 143/b –Mashtrimi kompjuterik;
- Neni 186/a –Falsifikimi kompjuterik;
- Neni 192/b –Hyrja e paautorizuar kompjuterike;
- Neni 293/a –Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike;
- Neni 293/b –Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike;
- Neni 293/c –Ndërhyrja në sistemet kompjuterike;
- Neni 293/ç –Keqpërdorimi i pajisjeve;
- Neni 117 –Pornografia;
- Neni 147 –Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës;
- Neni 148 –Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet;
- Neni 149 – Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit;
- Neni 149/a – Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale;
- Neni 149/b –Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit;
- Neni 232 –Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste; dhe
- Neni 232/a –Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste.

Një nga kërkesat më problematike nga agjencitë ligj zbatuese, e cila iu transferua ISP-ve përmes AKEP, ishte bllokimi i domain-it të faqes popullore në internet Jeta Osh Qef (Joq.al) pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 në Shqipëri. Më 30 nëntor 2019, faqet informative joq.al, joqalbania.com, dhe jetaoshqef.al u bllokuan pas akuzave kundër dy administratorëve të tyre, Erland Dalliu dhe Gentian Çengeli. Policia i referoi ata te prokurorët, për përhapje të panikut përmes publikimit të “lajmeve të rreme”. Është e paqartë nëse kërkesa për të bllokuar aksesin në këto faqe u bë nga policia, nga zyra e prokurorisë apo nga AKEP. Kjo çështje nuk u qartësua, as pasi Përfaqësuesi i Përhershëm i Shqipërisë në Këshillin e Evropës iu përgjigj¹³⁹ një pyetjeje të ngritur nga Platforma e

¹³⁹ Letër nga Albana Dautllari, Përfaqësuesja e Përhershme e Shqipërisë në Këshillin e Europës: <https://rm.coe.int/albania-replyrev-en-information-website-joqalbania-com-blocked-6januar/1680996a20>

KiE¹⁴⁰ për Promovimin dhe Mbrojtjen e Gazetarëve dhe Sigurinë e Gazetarëve.

Në një rast tjetër shqetësues pas të njëjtit tërmet, një aktiviste 25 vjeçare në Durrës, Xhuliana Aliaj, u arrestua më 1 dhjetor 2019 për “përhapje paniku” pasi postoi lidhje nga një faqe lajmesh italiane në faqen e saj në Facebook dhe pasi shkroi një status ku bënte thirrje për evakuimin e një pjese të qytetit nga frika e rrëzimit të ndërtesave. Në total postimi mori 27 ndërveprime, përfshirë pëlqime dhe komente. Masa e ashpër dhe disproporcionale e arrestimit të saj u pa gjerësisht si një vijimësi e përpjekjes së qeverisë për të kontrolluar me dhunë median dhe për të shtypur lirinë e shprehjes.¹⁴¹

Përveç sistemit të drejtësisë dhe agjencie ligj zbatuese, **Autoriteti i Medias Audiovizive** (AMA) autorizohet nga ligji nr. 97/2013, “Për Median Audiovizive”, të (a) licencojë median audiovizive, dhe (b) të luftojë shkeljet e të drejtave të autorit apo piraterinë në median audiovizive që ka licencuar. Më 2019, AMA i kërkoi AKEP të bllokojë përmbajtjen në 96 raste, që të gjitha të lidhura me filma apo ndeshje futbolli me të drejtë autori nga televizionet që i kanë marrë me licencë, por që i'u piratoheshin dhe transmetoheshin nga televizionet *online*.¹⁴² Gjithsesi, ligji 07/2013 mbi “Median Audiovizive” është i paqartë dhe nuk ofron përkufizim se çfarë është një televizion në internet, e aq më pak i qartë në lidhje me shërbimet OTT.

Në disa raste, kërkesa e AMA për të bllokuar një faqe të caktuar, që po transmetonte përmbajtje të paligjshme ka sjellë pasoja të papritura, ku ISP-të kanë bllokuar përkohësisht faqe *online* të nivelit të lartë. Për shembull, në prill 2020, AMA kërkoi për të bllokuar një faqe specifike të vendosur në platformën popullore gazetareske Medium.com – krijuesi i të cilit e kishte ngarkuar dhe kishte filluar të transmetonte një kopje të miratuar të një filmi nga një komedian shqiptar, Ermal Mamaqi. Por kjo solli bllokimin e përkohshëm të të gjithë platformës nga një pjesë e ISP-ve. Në përgjigje të

¹⁴⁰ Platforma është një hapësirë publike që lehtëson përpilimin, përpunimin dhe shpërndajren e informacionit mbi shqetësimet serioze mbi lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Vendet Anëtare të KiE, siç garantohet nga Neni 10 i KEDNJ:<https://www.coe.int/en/web/media-freedom/the-platform>

¹⁴¹ Reporter.al, 2019, <https://www.reporter.al/lirohet-25-vjecarja-e-arrestuar-per-perhapje-paniku/>

¹⁴² AKEP, 2020, Njoftim për shtyp, <https://www.akep.al/2020/04/20/informacion-per-publikun-nga-akep-lidhur-me-kufizimin-e-aksesit-ne-rrjet-te-disa-domain-dhe-faqe-interneti-nga-sipermarresit-e-rrjeteve-dhe-sherbimeve-elektronike/>

kësaj, Këshilli Shqiptar i Medias kritikoi bllokimin e Medium.com, si censurë. Më vonë, AMA i tha BIRN se ajo ka hartuar një procedurë të brendshme për të shmangur probleme të tilla.¹⁴³

Ligji nr. 155/2015, “Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë”, i jep Autoritetit Mbikëqyrës të Lojërave të Fatit (AMFL) mjetet për të bllokuar operatorët e palicencuar *online*. Përmes ligjit nr. 75/2018, i shtoi dhe ndryshoi ligjin 155/2015 “Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë”, kazinotë u kufizuan në hotelet me pesë yje, ndërsa dyqanet e basteve sportive, kazinotë në resorte dhe lojërat me terminal lotarie video (VLT) u lejuan të operojnë deri më 31 dhjetor 2018. Bazuar në kërkesat nga AMFL më 2019, AKEP i kërkoi ISP-ve të bllokojnë aksesin e më shumë se sa 8 mijë faqeve që ofrojnë akses në lojërat e bixhozit përmes internetit.¹⁴⁴

Gjatë një operacioni tjetër kundër lojërave të paligjshme të fatit më 2013, AKEP i kërkoi ISP-ve të bllokojnë aksesin e 500 faqeve të internetit, që ofronin lojëra fati të paautorizuara. Gjatë këtij operacioni, disa faqe bloggerësh të bazuar në platformën Word Press u bllokuan përkohësisht, me gjasa për shkak se u ngatërruan për faqe lojërash fati.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale autorizohet nga neni 30, paragrafi 1/b, i ligjit nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të urdhërojë bllokimin, fshirjen, shkatërrimin apo ndërprerjen e përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve e krijuar nga ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës,” është ngarkuar të mbrojë fëmijët dhe të miturit nga aksesin në përmbajtje të dëmshme apo të paligjshme në internet (neni 27). Agjencia detyron ISP-të, institucionet arsimore dhe institucionet e tjera publike apo private që ofrojnë akses në internet, të zbatojnë mjete teknike dhe masa të tjera për të mbrojtur fëmijët dhe të miturit nga aksesin në përmbajtje të dëmshme apo të paligjshme në internet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Ministrave të Shqipërisë miratoi një vendim më 2019 për të përkufizuar dhe detajuar më

¹⁴³ Citizen Channel, 2020, <https://citizens-channel.com/2020/04/22/vendimet-e-akep-per-mbyllje-te-faqeve-online-ngrene-shqetesime-per-censure-dhe-paligjshmeri/>

¹⁴⁴ AKEP, 2020, Njoftim për shtyp, <https://www.akep.al/2020/04/20/informacion-per-publikun-nga-akep-lidhur-me-kufizimin-e-aksesit-ne-rrjet-te-disa-domain-dhe-faqe-interneti-nga-sipermarresit-e-rrjeteve-dhe-sherbimeve-elektronike/>

shumë detyrimet e kompanive dhe institucioneve për të mbrojtur fëmijët. Vendimi nr. 465, datë 3 korrik 2019, “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet”¹⁴⁵ detyron ISP-të të bllokojnë menjëherë çdo faqe interneti që mban përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët. Faqet e paligjshme që janë bllokuar janë publikuar në portalin e administruar nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (ACESK).¹⁴⁶ Ligji detyron gjithashtu Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve të vlerësojë çdo raport nga palë të treta për rastet e përmbajtjes potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet dhe parashikon ndërmarrjen e masave të mëposhtme:

Të marrë masat e duhura në bashkëpunim me AMA për të bllokuar çdo përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët nga ofruesit e shërbimeve mediatike që janë identifikuar/ dhe

- Të marrë masa në bashkëpunim me AKEP për të bllokuar faqet e internetit kur është verifikuar se një faqe interneti mban përmbajtje të paligjshme dhe/ose të papërshtatshme për fëmijët në internet dhe t'i publikojë ato në portalin e ACESK.

Krye faqja e ACESK paraqet një baner që të dërgon te një formë në të cilën mund të raportohet përmbajtja e papërshtatshme, e cila mund të përfshijë ekspozim në imazhe dhe materiale të tjera me përmbajtje seksuale, bullizëm kibernetik, pornografi me fëmijë dhe postime të tjera fyese.

Përveç kuadrit rregullues të sipërpërmendur, Shqipëria ka ratifikuar edhe një numër konventash ndërkombëtare siç detajohet në kutinë më poshtë.¹⁴⁷

¹⁴⁵ Vendimi nr. 465, datë 3 korrik 2019, “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet” <https://www.unicef.org/albania/reports/new-cornerstone-law-adopted-protect-children-harmful-and-illegal-content-online>

¹⁴⁶ Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (ACESK), www.cesk.gov.al

¹⁴⁷ Lista është përshtatur nga Instituti Zviceran për Ligjin Krahësues, 2015: Blocking, Filtering, and Take-Down of Illegal Internet Content, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680651682>. Për një listë të plotë të konventave dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut që Shqipëria ka ratifikuar, shiko: <https://indicators.ohchr.org/>.

Konventa Ndërkombëtare

- “Konventa Evropiane për Krimin Kibernetik” ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25 prill 2002.¹⁴⁸
- Protokolli Shtesë i Konventës “Mbi Krimin Kibernetik dhe mbi Kriminalizimin e Akteve të Natyrës Raciste apo ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike”, ratifikuar me ligjin nr. 9262, datë 29 korrik 2004.
- Konventa “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual” i Këshillit të Evropës, ratifikuar me ligjin nr. 10071, datë 9 shkurt 2009.
- Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, ratifikuar me ligjin nr. 9834, datë 22 nëntor 2007.
- Konventa për parandalimin e terrorizmit të Këshillit të Evropës, ratifikuar me ligjin nr. 9641, datë 20 nëntor 2006.
- Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31 korrik 1996.
- Konventa “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me procesin automatik të të dhënave”, ratifikuar me ligjin nr. 9288, datë 7 tetor 2004.

Përveç kësaj, qeveria nuk kufizon apo dëmton aksesin në internet – përfshirë përmes autorizimit të mbylljes së pjesshme apo të plotë të internetit – apo përmes censurimit të përmbajtjes në internet. Nuk ka raporte të besueshme se ajo ka monitoruar komunikimet private *online* pa autoritet ligjor të përshtatshëm.¹⁴⁹ Bazuar në Kodin e Procedurës Penale,¹⁵⁰ prokurorët mund të kërkojnë që një ISP e caktuar të mbajë dhe dorëzojë komunikimet elektronike të të dyshuarve në një hetim penal.

¹⁴⁸ Në lidhje me nenin 42 të konventës, Shqipëria e ka ratifikuar marrëveshjen nën detyrimet e rrjedhura nga neni 10: Krimet e lidhura me shkeljet e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

¹⁴⁹ Raporti për të drejtat e njeriut në Shqipëri, Departamenti i Shtetit i SHBA, 2019, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/02/ALBANIA-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

¹⁵⁰ Ligji nr. 7905, date 21.03.1995, i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/PROJEKTLIGJ_KODI_I_PROCEDURAVE_PENALE_27_01_2014_FINAL_1-1.pdf

Siguria kibernetike

Shqipëria ka bërë progres domethënës gjatë viteve të fundit në zhvillimin e sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe në përdorimin e teknologjisë së informimit (TI). Ajo po shpejton për t'u bashkuar me “revolucionin” mbarëbotëror në teknologjitë e informimit, dhe praktikisht çdo pjesë e shoqërisë shqiptare – nga biznesi dhe politika, te e-qeverisja dhe arsimimi – është prekur nga ky zhvillim. Kjo mundësi, gjithsesi, shoqërohet me rreziqet e lidhura me sigurinë kibernetike dhe krimin kibernetik.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën mbi Krimin Kibernetik – të njohur si Konventa e Budapestit – më 25 prill 2002 me ligjin nr. 8888. Kodi Penal i Shqipërisë¹⁵¹ është kryesisht në linjë me këtë instrument të rëndësishëm ndërkombëtar dhe mbart nene specifike që luftojnë krimin kibernetik. Kodi i Procedurës Civile detajon gjithashtu rregulla mbi hetimet dhe mbledhjen e provave në lidhje me krimet kibernetike.¹⁵²Më konkretisht, kodi penal ka kriminalizuar aktivitete të tilla si:

- Hyrja e paautorizuar kompjuterike (Neni 192/b paragrafi1);
- Ndërhyrja në sistemet kompjuterike (Neni 293/c paragrafi1);
- Keqpërdorimi i pajisjeve (Neni 293/ç);
- Mashtrimi kompjuterik (Neni 143/b);
- Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike (Neni 293/b); dhe
- Vjedhja e identitetit dhe mashtrimi me identitetin (Neni 186/a).

Dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi apo fshirja e të dhënave nga sistemet ushtarake apo të dhënave të lidhura me sigurinë kombëtare, rendin publik, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen civile apo të dhëna të tjera me rëndësi publike është e dënueshme deri 10 vjet burg (Neni 293/b paragrafi2 i Kodit Penal).

¹⁵¹ Ligji nr. 7895, datë 27 janar 1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë,” i ndryshuar: <https://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/08/Criminal-Code-11-06-2015-EN.pdf>

¹⁵²Për një krahasim të detajuar mes Konventës së Budapestit dhe legjislacionit shqiptar, shiko Profilin ligjor të vendit te Këshilli i Evropës: https://www.coe.int/hu/web/octopus-old2019/country-legislative-profile/-/asset_publisher/LA6eR74aAohY/content/alban-1?_101_INSTANCE_LA6eR74aAohY_viewMode=view/

Megjithëse jo drejtpërsëdrejti e lidhur me sigurinë kibernetike, Kodi Penal detajon gjithashtu pasojat e ndërmarrjes së aktiviteteve të ndryshme anti-shoqërore në internet. Për shembull, një numër veprash të tjera penale të kryera përmes sistemeve kompjuterike – përfshirë krimet kundër njerëzimit, kërcënimet serioze për të vrarë apo plagosur apo krime urrejtjeje me bazë etninë, kombësinë, racën apo fenë – janë të dënueshme me gjobë ose me burg (nenet 74/a dhe 84/a të Kodit Penal). Ofrimi apo shpërndarja e materialeve me përmbajtje raciste apo ksenofobike përmes sistemeve kompjuterike në publik dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet (Neni 119/a i Kodit Penal). Fyerja publike në lidhje me etninë, kombësinë, racën apo fenë përmes një sistemi kompjuterik përbën një shkelje administrative dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet (neni 119/b i Kodit Penal).

Një ligj tjetër i rëndësishëm që qeveris sigurinë kibernetike është ligji nr. 2/2017, “Mbi Sigurinë Kibernetike”. Synimi kryesor i këtij ligji është që të arrijë një nivel të lartë të sigurisë kibernetike brenda Shqipërisë përmes hartimit të masave të sigurisë, të drejtave dhe detyrimeve, si dhe krijimit të bashkëpunimit të ndërsjellë mes enteve që operojnë në fushën e sigurisë kibernetike. Ky ligj zbatohet për sistemet e rrjeteve të komunikimit dhe informimit, dhunimi apo shkatërrimi i të cilave mund të prekë shëndetin, sigurinë dhe/ose mirëqenien ekonomike të shtetasve dhe funksionimin efikas të ekonomisë në Shqipëri.

Ia vlen të vërehet se jashtë hapësirës së këtij ligji janë rrjetet e komunikimeve elektronike dhe sistemet e informacionit që rregullohen nga ligjet për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe rrjetet e komunikimeve elektronike apo sistemet e informacionit që përpunojnë, arkivojnë apo transmetojnë informacion të klasifikuar shtetëror - si dhe rrjete të komunikimit elektronik dhe sistemet e informacionit që rregullohen nga ligji për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ACESK, i cili është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 9880/2008, “Për nënshkrimin elektronik”, dhe ligjin nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”. Misioni i saj është të garantojë sigurinë e shërbimeve elektronike, në veçanti të garantojë siguri dhe qëndrueshmëri

në transaksionet elektronike mes shtetasve, bizneseve dhe autoriteteve publike dhe të rrisë efikasitetin e shërbimeve publike dhe private dhe të tregtisë elektronike.

ACESK cakton gjithashtu operatorët e sigurisë së të dhënave dhe sistemeve/rrjeteve kompjuterike të shoqërisë së informacionit si dhe kushtet minimale teknike për Infrastrukturën Kritike të Informacionit (CII) me synimin e krijimit të një mjedisi elektronik të sigurt. Objektivi kryesor është për të krijuar besueshmëri për përdoruesit e firmës elektronike, shërbimet e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara dhe për të rritur sigurinë e rrjeteve të sistemeve të informacionit në Shqipëri. ACESK koordinon aktivitetet me institucionet e sigurisë dhe të mbrojtjes, bashkëpunon me autoritetet ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike, në veçanti në linjë me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet e përbashkëta. Ajo është ngarkuar gjithashtu me këto përgjegjësi për të:¹⁵³

- Të ndërmarrë masa për sigurinë kibernetike kombëtare;
- Të veprojë si pikë kontakti për operatorët e nivelit kombëtar përgjegjës për sigurinë e rrjetit dhe të ofrojë asistencë dhe mbështetje metodologjike për operatorët;
- Të inspektojë metodën e gjenerimit dhe menaxhimit të çelësave publikë dhe certifikatave elektronike;
- Të mbikëqyrë procesin e lëshimit të certifikatave elektronike të kualifikimit dhe zbatimit të nënshkrimit elektronik, identifikimit elektronik dhe shërbimeve të tjera të besuara.
- Të garantojë operatorët CII mbi identifikimin e sigurt të individëve që janë pajisur me certifikata elektronike të kualifikimit, të cilat përfshijnë edhe regjistrimin dhe akreditimin e Ofruesve të Besuar të Shërbimeve si dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të tyre;
- Të analizojë dobësitë në sigurinë e internetit;
- Të veprojë si skuadër reaguese kombëtare ndaj incidenteve me sigurinë kompjuterike (CSIRT);¹⁵⁴
- Të koordinojë punën për zgjidhjen e incidenteve në fushën e sigurisë kompjuterike;

¹⁵³ <https://www.trusted-introducer.org/directory/teams/akcesk/naeccs.html>

¹⁵⁴ Më shumë informacion mbi statusin e saj të akreditimit gjendet në: <https://www.enisa.europa.eu/topics/csirts-in-europe/csirt-inventory/certs-by-country-interactive-map#country=Albania>

- Të administrojë raportimet mbi incidentet e sigurisë kompjuterike;
- Të kryejë aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit në fushën e sigurisë kibernetike;
- Të ndërmarrë masa të tjera për sigurinë kibernetike të parenditura më sipër.



Qeverisja e internetit në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Tiranë, 2020

